



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “
"Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në
Edukim Shëndetësor".” i Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof.Asc.Dr. Robert ÇITOZI
2. Dr. Matilda LIKAJ

Prill 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" i Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.

| | | |
|-----|---|---|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan. |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve. |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 549 datë: 16.08.2012 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Urdhër i MASR 669, datë 29.12.2017 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Numer Unik Identifikimi -001688. |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikël i Dytë, Master Profesional |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 (dy) vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 kredite ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Jo |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Diplomë Master Profesional, "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 5 PAE / 12 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | Viti 1 = 53, Viti 2 = 71 Totali = 124 st |
| 19 | Komente / të tjera: | |

 2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i Ciklit të Dytë Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" është hapur sipas procedurës përkatëse që ka nisur me Vendimin e Senatit të UE Nr. 9, dt. 28.03.2012 për "Veprimtarinë e FSIE-së, mbi hapjen e Programit të ri të Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional "MP në Mësuesi për Lëndët Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", me VKM Nr. 549 datë: 16.08.2012, me Urdhër Ministri Nr. 4450/4, dt. 04.09.2012 dhe është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve. Ky program që në zanafillën e tij ka synuar në krijimin e një programi shumëdimensional ku teoria, praktika, kërkimi shkencor dhe praktikat mësimore të mësimdhënies të kishin një ndërthurje e korrelacion harmonik me synimin e një formimi sa më të plotë për një të nesërme e cila do të mundësonte punësim dhe kontribute në mësimdhënie në arsimin parauniversitar.

Në fillimet e tij, programi i studimit të Ciklit të Dytë të studimeve "MP në Mësuesi për Lëndët Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" në FSHE ishte me (90 kredite ECTS) , dhe është mbështetur në LAL 9741/2007 i ndryshuar "Për arsimin e Lartë në RSH". Me ndryshimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë në vitin 2015 ky program studimi u riorganizua nga me 90 kredite ECTS në dy vite me 120 kredite ECTS në përputhje me Ligjin 80/2015.

Sigurimi i një stafi pedagogjik të kualifikuar me grada dhe tituj si dhe sigurimi i ambienteve mësimdhënëse të standarteve europiane ka mundësuar pretendimet për një program studimi i cili me filozofinë "studenti në qendër" do të sigurojë një diplomë kompetitive në tregun e punës në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe atij Shëndetësor në Shqipëri.

Filozofia dalluese arsimore e këtij programi është se ai promovon dhe zbaton kombinimin e studimit akademik me mësimin e aplikuar në botën profesionale duke mundësuar që kompetencat specifike të tij të lidhen me aftësimin për të aplikuar një qasje sistematike në kërkimin shkencor, hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie për edukimin fizik dhe sportin në tërësi si dhe sugjerimin e zgjidhjeve në fushat e aktivitetit fizik për shëndet në veçanti.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" bëhet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017".

Mbështetur në dokumentacionin që disponojmë, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" nëpërmjet shërbimit në AMS.

Aplikimi zyrtar i IAL-së është dorëzuar në ASCAL më datë 20.12.2021: (Shkresë e IAL Nr.2938 prot, datë 20.12.2021, dërgon formularin e aplikimit (dokumenti bashkëngjitur në fund të hapit) - regjistruar ne protokollin e ASCAL Nr. 341 prot, datë 22.12.2021) ASCAL me dokumentin 133 Prot datë 23.03.2022 me lëndë: "Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 27 programeve të studimit", konfirmon aplikimin dhe pagesën e detyrueshme në bankë për programin e studimit që po vlerësohet.

Gjithashtu me Urdhër Nr.139 datë 30.11.2022 të ASCAL "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan jemi përcaktuar si ekspertë për vlerësimin e jashtëm të këtij programi studimi.

Nëpërmjet specialistëve të ASCAL ne si GVJ, jemi informuar në kohën e duhur mbi agjendën e fazës së vlerësimit për programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" (Universiteti "Aleksandër Xhuvani"). Gjithashtu në zyrat e ASCAL kemi zhvilluar trajnimin e duhur për procesin e vlerësimit të jashtëm të këtij programi studimi.

Kjo procedurë vlerësimi kulmoi me vizitën dyditore në institucion në dt. 11-12 Janar 2023 ku sipas agjendës arritëm të ballafaqonim dokumentet shkresore me realitetet konkrete me të cilat u përballëm. Jemi të bindur që ky proces vlerësimi ka respektuar maksimalisht kornizën ligjore të akreditimit të programeve të studimit në IAL-të shqiptare.



Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SËOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
"Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim
Shëndetësor"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË
"MËSUESI NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE ME PROFIL MINOR NË
EDUKIM SHËNDETËSOR"

| Standardi I.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | <p>Bazuar dhe mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, dalim në konkluzionin që ky program studimi i Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por është një vlerë e shtuar në tregun e punës si një ofertë akademike në përgatitjen e misionarëve të dijes në arsimin parauniversitar. Programi ka miratimin e ministrisë përgjegjëse dhe ofertën e tij akademike e sjell në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit.</p> <p>Nevojat në rritje të tregut të punës kanë sjellë si nevojë imediate hartimin e një programi të tillë multidisiplinar i cili normalisht që nga fillimi është ndjekur kryesisht nga studentët që përfundojnë ciklin e parë të studimeve Bachelor mbështetur mbi kërkesat gjithnjë e në rritje të një mësimdhënie sa më cilësore në Shqipëri, për profesionistë dhe specialistë të kualifikuar për të shërbyer cilësisht në sektorin e edukimit.</p> <p>Në Statutin e UNIEL thuhet: "Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani", si institucion i arsimit të lartë ka për mision:</p> <p>a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet;</p> <p>d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;</p> <p>e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;</p> <p>g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit mbart mbi vete traditën, historinë jo vetëm të një qyteti, por të një vendi dhe është pikërisht kjo përgjegjësi në raport me brezat dhe me kohën që bën që sfidat bazuar në ambicie të jenë dhe më të mëdha.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9: Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i></p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL-ja, UNIEL ka për |


| | |
|--|---|
| <p>hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>mision që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.</p> <p>UNIEL ka qëllim të ofrojë studime universitare të cikleve të ndryshme dhe në përputhje me kornizën europiane të kualifikimeve EQF dhe kornizën shqiptare të kualifikimeve KSHK, të lidhura ngushtë me praktikën dhe aplikimin për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirëinformuar. Program i studimit synon një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse duke krijuar një përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar, shërbime me vështrim ndaj biznesit dhe sipërmarrjes. Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" synon paisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të përballuar kërkesat e tregut të punës në fushat dhe sektorin përkatës. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</p> <p>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIE 2020-2024.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p> | <p>1. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është institucion publik i arsimit të lartë.</p> <p>3. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, dt.12.11.1991.</p> <p>4. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqiperisë", aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Ai është i akredituar për 6 vite deri në 26.11.2026 dhe ka synuar krijimin e një institucioni të arsimit të lartë cilësor, si një aktor zhvillimi i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, si dhe të ofrojë mundësi studimi përgjatë gjithë jetës. Ky program studimi kombinon sfidën akademike me trajnimin dhe aftësitë duke i pajisur studentët me kompetencat e domosdoshme profesionale, për punësim në të ardhmen.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" synon ndërtimin, ruajtjen, konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe një qasje zhvillimore të qëndrueshme dhe afatgjatë.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" i hapur me VKM Nr. 549 datë: 16.08.2012, me Urdhër Ministri Nr. 4450/4, dt. 04.09.2012 është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe është organizuar si program i ciklit të dytë master, në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë si dhe në kuadrin e Kornizës shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIE 2020-2024.</i></p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015.</i></p> | | |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> | <p>Programi i studimit Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" synon pajisjen e studentëve me kompetencat e nevojshme për të qenë të aftë të përballojnë kërkesat e tregut të punës në sektorin përkatës. Programi synon plotësimin e nevojave në rritje në vend për mësues të kualifikuar në fushën e edukimit fizik, sporteve dhe edukimit shëndetësor. Rritja e orëve mësimore javore në shkollat e arsimit parauniversitar, shtimi i qendrave të fitnesit si dhe turizmit sportiv dhe të aventurës janë mundësi të mëdha punësimi dhe zhvillimi ekonomik lokal apo kombëtar. Ky program studimi mbështetet në Kartën e Bolonjës, AHESIS, ECTS etj. Objektivi kryesor i UE-së është të formojë profesionistë të aftë për të përballur sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave humane, natyrore, ekonomike, të edukimit si dhe shkencave mjekësore e teknike.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</i></p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIE 2020-2024.</i></p> | | |
| Konkluzione | <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|--|-------------------------------|
| Standardi I.2 | |
| Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>UNIEL me dokumentacionin e paraqitur na dëshmon se në tërësinë e tij ai ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi në atë fushë. Nga viti në vit pasqyrat dhe tabelat e paraqitura evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesëshme. Ata janë emra të spikatur në fushën e shkencave sportive, biomjekësore dhe sociale dhe garantojnë realizimin e plotë dhe efikas të programit të studimit.</p> <p>Në programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar në total 17 staf akademik me kohë të plotë dhe i ftuar, prej të cilëve 5 me titullin Prof.Dr, 5 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 3 Doc. Nga shqyrtimi i programit, vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit, duke mundësuar si output për studentët fitimin e kompetencave (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) në përfundim të programit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor". Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve lëndore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL 2020-2024.</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Fasha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Ky fakultet përmbledh fushat e studimit si: Psikologjia, Puna Sociale, Mësuesi, Shkenca Sociale e Edukim Qytetar, <i>Sportet dhe Edukimi Fizik</i>. Vetë emërtimi i Fakultetit është një sintezë e të gjitha fushave të përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Ky rakordim vërtetohet edhe në programet e ofruara nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, ku përfshihen: Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"; dhe Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor"</p> <p>Programi mësimor është i është regjistruar si program i ciklit të dytë Master Profesional me 120 kredite ECTS. Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe tenton të jetë i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL" i ndryshuar" dhe përpiqet të jetë korrekt me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL 2020-2024.</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në</i></p> |




| | |
|--|---|
| | Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor. |
| Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Në kushtet e mungesës së kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” institucioni, që nga themelimi i tij ka zbatuar kodifikimin e vet të programeve të studimit dhe lëndëve në përputhje me fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Studimet ndërdisiplinore, të quajtura edhe studime të përgjithshme të mëdha dhe që përmbajnë një numër kursesh apo modulesh të ndryshme dhe që lejojnë përshtatjen e diplomës dhe mundësojnë zgjedhjen e disa varianteve studimore në vazhdim nuk ofrohen nga institucioni për momentin. Në një të ardhme do të ishte mirë që njësia kryesore dhe ajo bazë të mendojnë seriozisht për studime ndërdisiplinore të cilët zgjerojnë mundësitë e varianteve të studimit për studentët.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022. Evidenca 1.3 Strategjia e UNIE 2020-2024. Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> |
| Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Institucioni pra konkretisht UNIEL dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Edukimit nuk ofrojnë program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit. |
| Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | <p>Institucioni i arsimit të lartë UNIEL ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit e paraqitur kjo edhe në dokumentin lista e trajnimit të studentëve: 1. “Si të luftojmë dezinformimin”, 2. Akademia e Medias, 3. “Klubi i Debatit”, 4. “Integrimi i studentëve në tregun e punës”, 5. Projekti ‘Përtej Gardheve 2’, 6. Seancë trajnimi me profesorë të Humboldt-Universitët zu Berlin, 7. “Klubi i Debatit”, 8. “Validimi i kompetencave në fushën e marketingut të shërbimeve dhe sjelljes konsumatore”, 9. “Drejtësi për të Gjithë” 10. “Klubi Debatit”. Njësia bazë duhet të krijojë kontakte jo vetëm me shkollat e arsimit parauniversitar (Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Elbasan) por të mundësojë trajnime dhe bashkëpunime edhe me bizneset e fitnesit dhe turizmit sportiv dhe të aventurës.</p> <p>Evidenca 1.10 Lista e trajnimit të studentëve. Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</p> |
| Konkluzione | Ky standart përmbushet plotësisht. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Grupi i vlerësimit të Jashtëm (GVJ) mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga IAL-ja del në konkluzionin se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e mirëpërcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UNIEL. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara midis njësive të ndryshme, por evidentohet qartë që pesha kryesore superohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor".

Në aktet rregullatore janë të përcaktuara qartë roli i drejtuesit të njësisë bazë, si dhe të koordinatorit të departamentit. Institucioni dhe drejtuesit e tij nxisin bashkëpunimin midis stafeve akademike dhe ndihmëse brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar mënyrën e duhur për të pasur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis tyre.

Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.

Evidenca 1.11 Struktura organizative e UNIEL.

Evidenca 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.

Evidenca 1.15 Analizë vjetore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.



UNIEL ka një numër të madh marrëveshjesh (rreth 60) me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron.

UNIEL ka një rrjet të konsiderueshëm marrëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikat profesionale të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj.

UNIEL ka nënshkruar marrëveshje me IAL ndërkombëtare që janë: Universiteti i Veliko Tarnovo, Bullgari; Universiteti i Firenzes; Zurich University of Teacher Education; Polypheno srl, "Aldo Moro", Bari; John Paul II Catholic University, Lublin; Universiteti Oviedo; UISP (Unione Italiana Sport per Tutti); Trakia University, Stara Zagora, Bulgaria dhe ka marrëdhënie e marrëveshje bashkëpunimi me pothuajse

| | | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|--|
| | <p>të gjitha universitetet shqiptare publike e private në Shqipëri dhe rajon. Vlen të theksohet që në kuadër të ndërkombëtarizimit Fakulteti i Shkencave të Edukimit në bashkëpunim me Universitetin "Aldo Moro" Bari, Itali, po ofrojnë Master Shkencor të përbashkët në "Shërbime Sociale" ku 40% e krediteve ECTS do jenë të njëjta.</p> <p><i>Evidenca 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p> <p><i>Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus.</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se UNIEL në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët e Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh si psh. Drejtoria Rajonale Korçë, ZVA Elbasan etj. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shkolla, të ndryshme, me spitale, qendra rehabilitimi apo fitnesi etj.</p> <p>Në gjykimin tonë ky numër i konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit krijon kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësinë e duhur.</p> <p><i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit me qëllim mbarëvajtjen e procesit të arsimimit cilësor të programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" duke patur një numër të konsiderueshëm studentësh për mësuesi ka edhe një numër jo të vogël marrëveshjesh bashkëpunimi.</p> <p>Për të bërë të matshëm efikasitetin e këtyre bashkëpunimeve konstatojmë nga dokumentacioni i paraqitur se njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.15 Analizë vjetore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | |
| | | | <p>X</p> | |



| | | | |
|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË



| Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>GVJ-ja pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit dhe pas sqarimeve në vizitën në institucion del në konkluzionin se programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite në module që formojnë lëndët, dhe bazuar në Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në manualin e hartimit të programeve të studimit përcakton orët për kredit dhe studim individual.</p> <p>Sipas VKM 41, Dt. 24.01.2018: Lëndët Bazë A duhen 5-10% janë 12 ECTS ose 10% √, Lëndët Karakterezuese B duhen 30-40% dhe në planin mësimor janë 46 ECTS ose 38% √, Lëndër ndërdisiplinore integrale C DUHEN 20-30% janë 28 ECTS ose 23% √, Lëndët plotësuese D duhen 10% janë 12 ECTS ose 10% √, Detyrimet përmbyllëse E duhen 10-20% janë 22 ECTS ose 18% √.</p> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL.</i> <i>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</i> <i>Evidenca 2.10. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</i> <i>Evidenca 2.11. VKM Nr. 41, date 24. 01. 2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në</p> | <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor, Neni 6, Misioni thuhet se ky program studimi ka për mision:</p> <p>a. Të përgatisë mësues të Edukimit fizik të aftë për të zhvilluar veprimtarinë mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar.</p> <p>b. Të përgatisë profesionistë të zotë në mësimdhënie me interes për dijen dhe kërkimin shkencor.</p> <p>c. T'u ofrojë profesionistëve të ardhshëm koncepte dhe aftësi të planifikimit, drejtimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të veprimtarive mësimore.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>d. T'u ofrojë studentëve një formim intelektual, duke përfshirë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së mësimdhënies në lëndët përkatëse.</p> <p>e. T'i orientojë studentët drejt një mësimdhënieje sa më të suksesshme, si edhe kërkimit didaktik dhe pedagogjik në të gjitha disjplinat shkollore.</p> <p>f. Demonstrimi i gatishmërisë dhe i shtathtësive për zhvillimin e projekteve në institucionet arsimore.</p> <p>g. Zhvillimi i shkathtësive për hulumtime në mjedise shkollore dhe më gjërë.</p> <p>Synon përgatitjen e formimit të specialistëve të aftë dhe me kompetenca profesionale për të ofruar shërbime për të tretët dhe konsulta në fushat e edukimit fizik, edukimit shëndetësor, sporteve, fitnesit dhe veprimtarive sportive e rekreative.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> <p>Evidenca 2.9 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Në Planin Mësimor të programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor në tipin e veprimtarisë të Lëndëve Plotësuese 16 ECTS është e planifikuar ngarkesa mësimore/akademike e Praktikës Profesionale në EF me 8 ECTS dhe një total prej 300 orësh.</p> <p>Përsa i përket detyrimeve përmbyllëse ato kanë një volum prej 22 ECTS dhe nga njësia bazë në vizitat në institucion u informuam që kjo realizohet ë me provim përfundimtar.</p> <p>GVJ sugjeroi që për studentët me mesatare të ponderuar mbi 9 të ofrohet nga njësia bazë dhe mbrojtje diplome sa kohë institucioni ka të gjitha kapacitetet akademike (grada + tituj) për ta realizuar me sukses këtë gjë.</p> <p>Evidenca 2.10. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> <p>Evidenca 2.11. VKM Nr. 41, date 24. 01. 2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve</p> | <p>Si GVJ morëm informacion se në vitin 2013 njësia bazë si pjesmarrëse në projektin ndërkombëtar SPEED Tempus Projekt, 544362-TEMPUS-1-2013-1-TEMPUS-JPCR “Sport Professions: Education, Employment, Development, in Balkan Region” nga viti 2013-2016 u rishikuan syllabuset dhe u përpunua programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për lëndët Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor”, në përputhje me rekomandimet e AEHESIS por njëkohësisht duke respektuar dhe ruajtur përputhjen me legjislacionin në fuqi. Ky projekt synonte dhe realizoi unifikimin e kurrikulave të Universiteteve partnere të projektit në përputhje me kurrikulën dhe standartet Europiane, të përcaktuara prej AEHESIS</p> |

| | |
|---|---|
| <p>“Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> | <p>(Aligning European Higher Education Structure in Sport Sciences).</p> <p>Siç është paraqitur në RVB - Programet Master Profesional në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit. Në programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” janë të përcaktuara - Disiplinat të formimit bazë (12 kredite), me modulet: Filozofi e Sociologji Edukimi, Edukim Gjithpërfshirës, Psikologji Zhvillimi, Psikologji Edukimi, Etika Profesionale e Mësuesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Disiplina të formimit karakterizues (46 kredite) me lëndët si: Kurrikula dhe Mësimdhënia, Statistikë e avancuar, Kërkimi Sasior e Cilësor, Seminar Kërkimor, Metodikë e Lojrave Sportive, Metodikë e Sporteve Individuale, Didaktikë e Edukimit Shëndetësor, Mësimdhënie e Edukatës Seksuale, Aktiviteti Fizik dhe të Ushqyerit, Koncepte të Mirqenies Fizike dhe strategjitë Parandaluese, Aktiviteti Fizik i Adaptuar i Avancuar, Ndihma e parë dhe Siguria personale. - Disiplina të formimit ndërdisiplinor dhe integruese (28 kredite) Kontrolli Motor dhe të mësuarit tij, Edukimi Lëvizor, Biologji e Avancuar e Ushtrimit të Aktivitetit Fizik, Fiziologji e Avancuar e Ushtrimit të Aktivitetit Fizik, Disiplina plotësuese (12 kredite), ku bën pjesë: Gjuhë e Huaj për Qëllime Specifike, Teknologjia e Komunikimit dhe Informacionit në Edukimi, - Praktika Profesionale e Mësimdhënies dhe; - Detyrime Përmbyllëse (22 kredite), ku bën pjesë Provimi Përfundimtar i Formimit ose Mbrojtje Temë Diplome. <p>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” Neni 14, 15);</p> <p>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor, tabela 9.</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p> | <p>Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për lëndët Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor”, është i organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015, VKM 41, e ndryshuar dhe Statutin e Rregulloret institucionale me 2 vite studim ku secili vit ka 60 kredite ECTS në total $2 \times 60 = 120$ ECTS. Ky program studimi plotëson 25 kreditet në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik me module të tilla shumë formuese si; Filozofi dhe sociologji edukimi, Edukim gjithpërfshirës, Etika profesionale e mësuesit, Bazat psikologjike të zhvillimit dhe edukimit (Psikologji zhvillimi, Psikologji edukimi) etj.</p> <p>Në këtë program studimi pranohen vetëm ata studentë që kurrikula e tyre e Bachelor ka së paku 80% ngjashmëri me kurrikulën e Bachelor në UNIEL. Këtë përputhje e verifikon komisioni AD-HOC i transferimit dhe njohjes së krediteve nga institucioni ku kandidati për</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>këtë program studimi ka përfunduar studimet bachelor. Ky komision ngrihet brenda Departamentit që mbulon këtë program studimi. <i>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" Neni 14, 15);</i> <i>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor, tabela 9.</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Në Nenin 28 Politika e pranimi të Rregullores së Programit të Studimit thohet: Çdo vit akademik, për të ndjekur Programin "Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" pranohen studentë, të cilët: 28.1 Zotërojnë një diplomë universitare të nivelit të parë Bachelor në të njëjtin profil ose në profil të ngjashëm me atë të programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" në përputhje me legjislacionin në fuqi. 28.2 Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor konkurruese. 28.2. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës që nënkupton vlerësimin tërësor të treguesve të kandidatit që përfshijnë arritjet akademike, përputhjen e interesave të kandidatit. 28.3. Për përzgjedhjen e kandidatëve ngrihet Komisioni i pranimi. Vendimin për kandidatët fitues e merr Komisioni i pranimi. Dekani shpall listën e kandidatëve të pranuar bazuar në vendimin e Komisionit të pranimi. Në GVB theksohet: Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" me 120 kredite, 4 semestra, është në përputhje me ligjin 80/2015 të Arsimit të lartë dhe specifikat e përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit. Ky program studimi është tërësisht në funksion të kualifikimit të mësuesve në Edukimi Fizik e Shëndetësor dhe më gjerë. <i>Evidenca 2.11 Vendimi Nr. 41 keshillit të ministrave datë 24.01.2018.</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Neni 15 pika 3, Neni 16).</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" Neni.11, 28.</i></p> |

| <p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p> | <p>Në dokumentacion shikojmë që Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka aplikuar dhe qenë pjesë aktive në projektin Tempus me Programin Master "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor". Pjesëmarrja në projekt i obligonte të gjitha universitetet pjesëmarrëse për të njëjtësuar me këtë program studimi programet e tyre master në mësuesi. Pjesë e këtij projekti ishin dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Universiteti i Shkodrës të cilat në përfundim të këtij projekti kanë së paku 70 për qind përmbajtje të ngjashme të programeve të njëjta apo të ngjashme të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.19 Bashkëpunime ndërkombëtare, projekte ku UNIEL</i></p> | | | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| <p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> | <p>GVJ konstaton se kodifikimi i Programit të Studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" është në proces realizimi në MAS.</p> <p>UNIEL i ka paraprirë procesit të kodifikimit të lëndëve të programit të studimit. Të gjitha lëndët janë të kodifikuara dhe të pasqyruara në sistemin EMS të UNIEL.</p> <p><i>Shembull: Kodi/Përshkrimi</i></p> <p>MAP-DEF-3 - Didaktika e Edukimit Fizik dhe Lojrave MAP-EPM 1-3 - Etike Profesionale e Mësuesit MAP-ETD-3 - Edukim Teknologjik dhe Didaktikë</p> <p><i>Evidenca 1.9 Pasqyrimi i kodifikimit të lëndëve të programit të studimit MP "Mesuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor".</i></p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> | <p>Në takimin me Dekanan e Njesisë kryesore mësuam se FSHE por edhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit në kuadrin e ndërkombëtarizimit që është iniciuar nga qeveria shqiptare, janë duke punuar për të realizuar bashkëpunime me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit për të realizuar edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht hap i parë është hedhur me Universitetin "Aldo Moro" të Barit, Itali për një Master Shkencor të përbashkët në "Shërbime Sociale".</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL.</i></p> | | | | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="534 1559 738 1637">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="738 1559 927 1637">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="927 1559 1145 1637">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="534 1637 738 1680"></td> <td data-bbox="738 1637 927 1680"></td> <td data-bbox="927 1637 1145 1680">X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| | |
|-----------------|-------------------------------|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|-----------------|-------------------------------|



| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Fakultetit të Shkencave të Edukimit përbëhet nga katër njësi bazë, apo departamente dhe një qendër:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies - 2. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar - 3. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve - 4. Departamenti i Psikologjisë - 5. Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin në Edukim <p>Në Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, që është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar në total 17 staf akademik me kohë të plotë dhe i ftuar, prej të cilëve 5 me titullin Prof.Dr, 5 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 3 Doc. Njësia bazë plotëson numrin 7 dhe është i plotësuar sipas ligjit me grada e tituj dhe një asistent lektore pritet të fillojë këtë vit programin e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Neni 23, pika 1, faqe 15.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor); Apendix Tabela 10.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> | <p>Në programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar në total 17 staf akademik me kohë të plotë dhe i ftuar, prej të cilëve 5 me titullin Prof.Dr, 5 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 3 Doc. Departamenti ka edhe personel ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> <p>Ky Program Studimi, përveç këtyre lëndëve Praktika Profesionale në EF nuk ofron praktika laboratorike dhe klinike. Praktikrat laboratorike realizohen më së shumti në ciklin e parë të studimeve "Bachelor", nën mbështetjen edhe të stafit ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidenca 1. 2 Rregullore e Studimeve UNIEL Neni 35, pika 2.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Në strukturën e UNIEL është i parashikuar një koordinator për çdo departament i cili është edhe Përgjegjësi i Njesisë Bazë që koordinon punën e tij me pedagogët përgjigjës të programit të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave, por koordinatori dhe pedagogu përgjegjës për praktikrat profesionale duhet të raportojnë periodikisht në analizat e departamentit.</p> <p>Koordinatori mban kontakte të vazhdueshme me stafin akademik,</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | ndihmës Akademik, Zyrën Vendore Arsimore si dhe me studentët e programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. <i>Evidenca 1. 2 Rregullore e Studimeve UNIEL Neni 35, pika 2.</i> | | |
| Konkluzione | <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi II.3 | |
| Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe Fakulteti i Shkencave të Edukimit (FSHE), zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”</p> <p>Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p>Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit (https://uniel.edu.al/) dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL 2020-2024.</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</i> <i>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor) Apendix Tabela 12.1</i></p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfaqësohet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” është i organizuar sipas sistemit ECTS dhe sipas kategorive (A-E), dhe i qëndrojnë korrekt</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>peshës së përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës) – 12.3 orë për 1 kredit ECTS, si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit – 12.7 orë për 1 kredit ECTS.</p> <p>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” Neni 14, 15);</p> <p>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor, Apendix tabela 9.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet Zyrës të Pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njëhësim studimesh.</p> <p>Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit (uniel.edu.al), si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit – Neni 28, Kriteret e pranimit thuhet se duhet të: 28.1 Zotërojnë një diplomë universitare të nivelit të parë Bachelor në të njëjtin profil ose në profil të ngjashëm me atë të programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" në përputhje me legjisllacionin në fuqi.</p> <p>28.2 Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor konkurruese.</p> <p>Procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve përcaktohen në nenin 13 të këtij dokumenti.</p> <p>Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/program të mëparshëm studimi parashikohet në rregulloren e fakultetit.</p> <p>UNIEL ofron mundësi për transferime të studentëve në Vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Studentët e UNIEL të cilët duan të transferohen në universitete të tjera të vendit, në program të të njëjtit cikël, paraqesin kërkesën në dekanin e fakultetit ku kryejnë studimet.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Kreu IV, Neni 50, 51, 52, 53.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit</p> | <p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për</p> |

| | |
|--|---|
| <p>përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p><i>Konstatohet që në jo pak syllabe ka nevojë për korrigjime sidomos në drejtim të mosvendosjes korrekte të literaturës apo faqeve që i korespondojnë temës në librin e rekomanduar. Duhet parë me vëmendje përcaktimi i literaturës së rekomanduar që do ishte mirë të ishin në kategorine leading books nga Human Kinetics duke ofruar prurjet më bashkëkohore tek studentët por edhe për stafin akademik.</i></p> <p>Në syllabus të lëndës/modulit specifikohen me detaje përshkrimi dhe objektivi i modulit, rezultatet e të nxënit, detyrimet e studentit dhe vlerësimi i tyre, si dhe parashtrimi për çdo javë edhe orë të seminarëve dhe ushtrimeve, duke specifikuar edhe metodologjinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca SYLLABE. Evidenca 2.11 VKM 41, dt. 24.01.2018. Apendix tabela 9, 10.)</p> |
| <p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p> | <p>Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti, dhe rregullohet përmes Politikës së UNIEL “Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit”. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga Departamenti përkatës, Fakulteti, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave nën Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senatit Akademik, dhe dosja e plotë arkivohet.</p> <p>Syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit që prezantohet në lëndë të ndryshme.</p> <p>Sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në planin mësimor bëhen deri në masën 20% për programe të akredituara. Shpesh arsye për ndryshim bëhen daljet e VKM-ve apo udhëzimeve të reja nga institucionet që drejtojnë e normojnë punën në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Alumni nxjerr shpesh në pah nevoja për përmirësim, ide të reja dhe propozime për ndryshime që përmirësojnë programet mësimore në përputhje me dinamikën apo nevojat e tregut të punës i cili kalon mes procesesh të vazhdueshme ndryshimesh e transformimesh.</p> <p>Evidenca 2.9. Plani Strategjik i zhvillimit të FSHE, pika 1, 3, faqe 9.</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Ndonëse ka vend për disa përmirësime në syllabet e disa moduleve kryesisht në vendosjen korrekte të literaturës e faqeve të saj, gjykojmë që ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |



Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> | <p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C D dhe E.</p> <p>Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t'u punësuar jo vetëm si mësues të edukimit fizik dhe sporteve por dhe për tregun e fitnesit dhe aktivitetit fizik për shëndet. Konstatohet që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi.</p> <p>Në RVB theksohet: Ky program studimi ju siguron mundësi punësimi studentëve si mësues në sistemin parauniversitar, pranë klubeve sportive dhe shoqatave sportive si drejtues, trajnerë, menaxherë etj. Në palestra si punonjës fitnesi dhe rekreacioni, si punonjës në administratën publike apo private.</p> <p><i>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> | <p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), të përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Konkretisht rezultojnë se:</p> <p>Lëndët Bazë A duhen 5-10% janë 12 ECTS ose 10% √, Lëndët Karakterezuese B duhen 30-40% dhe në planin mësimor janë 46 ECTS ose 38% √, Lëndër ndërdisiplinore integruese C DUHEN 20-30% janë 28 ECTS ose 23% √, Lëndët plotësuese D duhen 10% janë 12 ECTS ose 10% √, Detyrimet përmbyllëse E duhen 10-20% janë 22 ECTS ose 18% √.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u la si këshillë që në planin mësimor të shikohet mundësia e vendosjes së orëve të plota mësimore pra psh; jo 12.5 leksione e 4.5 seminare, por 12 leksione e 4 seminare sepse kështu është më e lehtë për tu kalkuluar kur kemi të bëjmë me transferime kreditesh nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.10. Plani Mësimor i Programit të Studimit Master</i></p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”. Evidenca 2.17. Modeli i syllabuseve.</p> |
| <p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> | <p>Programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", sipas bisedave dhe konsultimeve me drejtuesit dhe stafin akademik të programit është organizuar dhe hartuar duke konsultuar e marrë në konsideratë programe të ngjashme ndërkombëtare si dhe përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS) dhe AEHESIS. Një kredit është i barazvlefshëm me 25 orë punë të studentit, ku përfshihet dhe koha e orëve individuale të studimit të cilat duhet të jenë më shumë se gjysma e tyre konkretisht 12.3 orë është ngarkesa akademike dhe 12.7 orë është koha e orëve individuale të studimit Ngarkesa vjetore e një studenti, që ndjek këtë program studimi është 60 kredite ECTS.</p> <p>Në Planin Mësimor të Programit të Studimit janë 535 orë Leksione, 640 orë Seminare e ushtrime, si dhe 300 orë praktika të cilat sigurojnë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional tek studentët.</p> <p>Evidenca 2.10, Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</p> <p>Evidenca 2.16 Profesionet e Sportit: Arsimim, Punësim, Zhvillim në rajonin e Ballkanit.</p> |
| <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Konstatohet se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integritet të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Statuti i UNIEL ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Nenet 56, 57 dhe 58 të Statutit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandëe Xhuvani”.</p> <p>Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit UNIEL dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.</p> <p>Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe mundësi për punësim pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. 17.02.2022.</p> <p>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> <p>Evidenca 2.15 Model Programi e Syllabus i Praktikës Profesionale.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> | <p>Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Gjatë shqyrtimit të syllabeve të programeve të lëndëve të programit të studimit konstatojmë se një pjesë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Por, konstatojmë edhe disa problematika:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ka syllabe ku është vendosur literatura pa faqet për tematikë -Ka syllabe ku literatura është e vjetër -Ka syllabe ku 100% e literaturës është e huaj <p>Sugjerojmë që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore.</p> <p><i>Evidenca 2.18 https://uniel.edu.al/biblioteka-online.</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> | <p>Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe dokumentacionin plotësues të tij konstatojmë që programi Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", është i përqëndruar në marrjen e njohurive të thelluara në profesionin e rregulluar me ligj të mësuesit të disiplinave e sportive fokusuar në mësimdhënie me fëmijët dhe adoleshentët.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit garanton edhe fitimin e njohurive dhe kompetencave për të realizuar kërkim shkencor në fushat e stërvitjes dhe pedagogjisë sportive gjë e cila mundet të mundësojë në të ardhmen riorganizimin e këtij programi në Master Shkencor në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor".</p> <p><i>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe dokumentacionin plotësues të tij konstatojmë që programi Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", është i përqëndruar në marrjen e njohurive të thelluara në profesionin e rregulluar me ligj të mësuesit të disiplinave e sportive fokusuar në mësimdhënie me fëmijët dhe adoleshentët.</p> <p>Në RVB theksohet se "Përmbajtja e programeve të studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor", ju mundëson studentëve të diplomuar mundësi punësimi si, mësues i EF e Shëndetësor në AP, si atë publik ashtu edhe atë jopublik, si trajner, instruktor me ekipet sportive të moshave të reja, punonjës në administratë në institucionet publike, punonjës në shoqatë, klube dhe organizata sportive.</p> <p><i>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ ndonëse jep disa rekomandime për të riparë disa syllabe kryesisht në drejtim të korrektimit të problemeve me literaturën bazë e të</i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | rekomanduar e gjen standardin të përmbushur plotësisht. | | |
|-------------------------------------|---|----------------------|-----------------------|
| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> | <p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit të FSHE-së 2020-2024 theksohet se Objektivi kryesor i FSHE-së është të formojë profesionistë të rinj, konkures në tregun e punës në fushat e mësuesisë, shërbimeve sociale psikologjike. Të forcojë pozitat akademike dhe shkencore si Fakulteti i cili diplomon mësuesit e së nesërme në një shtyllë të rëndësishme të arsimit në vend. Të nxisë politikën arsimore dhe sociale drejt përmirësimit të tyre dhe të kthehet në fakultetin më të rëndësishëm në vend dhe rajon duke ruajtur traditën dhe duke adoptuar ndryshimin.</p> <p>Këto ndryshime e përmirësime përfshijnë dhe përmbajtjen e programit të studimit duke e përshtatur atë me kërkesat dhe dinamikën e reja që tregu i punës kërkon. FSHE-ja ka garantuar një bashkëpunim efektiv dhe serioz me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Elbasanit dhe të qyteteve të tjera të qarkut Elbasan në përditësimin e informacionit që ka të bëjë me nivelin profesional të mësuesve të edukimit fizik gjatë punës së tyre konkrete, si dhe bashkëpunimi i ngushtë me federatat sportive në drejtim të kualifikimit të vazhduar të trajnerëve të rinj dhe punësimin e tyre.</p> <p>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për riorganizimin e programit. Evidenca 2.16 Profesionet e sportit Arsimim Punësim, Zhvillim në rajonin e Ballkanit. Evidenca 2.9 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> | <p>Si në Statutin e UNIEL ashtu edhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-24 thuhet se: UNIEL ka për mision që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe së ardhmes, si qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.</p> <p>Shtylla e studentit në qendër e fokusuar në veprimtaritë studentore dhe komunitare. NJZHKC-ja organizon në fund të çdo semestri pyetësin me studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. (Rregullore e Njesise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilesise). Organizon fokus grupe me studentët ku Departamenti zhvillon në mënyrë periodike takime me studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë.</p> <p>Evidenca 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL. Studentët</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Evidenca 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor.</i> | | | |
| Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Në RVB theksohet se “Fakulteti i Shkencave të Edukimit në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Elbasanit, institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor, Bashkia e Elbasan, KOKSH, Federata të ndryshme sportive, subjekte private të fitnesit e rehabilitimit sportiv etj, përditëson përshtat dhe riorganizon programin e studimit, programe të posaçme në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike lokale të tregut të punës në vend dhe pse jo dhe jashtë kufinjve. <i>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për riorganizimin e programit. Evidenca 2.16 Profesionet e sportit Arsimim Punësim, Zhvillim në rajonin e Ballkanit. Evidenca 2.9 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Standardi përmbushet plotësisht.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi II.6 | |
| Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Në rregulloren e programit të studimit, theksohet se programi ka këto objektiva: -Tu ofrojë studentëve dije njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e ef dhe sportit. -Të pajisë studentët me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra. -Të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi për kërkim shkencor në këtë fushë etj Pjesë e veprimtarive mësimore është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit, esseve, projekteve dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe në periudhën e provimit përfundimtar apo punimit të diplomës. <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, Neni 62. Evidenca 1.7 Rregullore e studimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Evidenca 2.9 Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e | GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve qëndrojnë në krye të organizimit dhe koordinimit të veprimtarisë së mësimdhënies, veprimtarive kërkimore |

| | |
|--|--|
| <p>mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> | <p>ose sportive, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik me moton studenti në qendër.</p> <p>Njësia kryesore dhe ajo bazë nxisin dhe inkurajojnë anëtarët e tyre të marrin pjesë në ëorkshop-e, leksione të hapura apo projekte kërkimore me karakter aplikativ etj.</p> <p><i>Evidenca 1.15 Analizë vjetore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 2.12 Vendim departamenti për ndarjen e grup lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 2.13 Libri i abstrakteve të Konferencës Ndërkombëtare 2021.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p> | <p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit theksohet se ky program synon të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierën profesionale. Kompetencat specifike të programit lidhen me aftësimin për të aplikuar një qasje sistematike në kërkimin, hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie për edukimin fizik dhe sportin.</p> <p>Konstatojmë nga bisedat me studentët e këtij programi studimi se pedagogët i nxisin studentët që detyrën e kursit, ta realizojnë në terren duke kryer një ministudim, bazuar në kriteret strikte të kërkimit shkencor. Duke qenë se detyrimeve përmbyllëse në master profesional kanë obligative edhe përgatitjen e një punimi shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sportive nga studentët me rezultate të larta, ideimi dhe formësimi i projektit studimor nis në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve dhe pedagogu udhëheqës motivon dhe nxit studentin të hulumtojë mbi tema të ndryshme që lidhen me interesat e tyre dhe të kërkojë mbi metodën më të përshtatshme për hulumtim.</p> <p>Në konferencat ndërkombëtare të organizuara nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve kanë marrë pjesë edhe studentë të Masterit Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</p> <p><i>Evidenca 1.15 Analizë vjetore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 2.13 Libri i abstrakteve të Konferencës Ndërkombëtare 2021.</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> | <p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit theksohet se: Studentët e rregjistruar në këtë program studimi do të mundën dhe do të dijnë të konkurojnë në tregun e punës jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj. Për këtë do të kërkohen burime të reja financimi dhe plane më të sofistikuara mbështetëse: për laboratorë të kërkimit të aplikuar, biblioteka interactive e të personalizuara, investime thelbësore në infrastrukturën sportive etj.</p> <p>Për realizimin e aktiviteteve me karakter kërkimor njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në UNIEL administrimi i të ardhurave nga aktivitetet apo projekteve kërkimore realizohet në nivel institucional. Administratori i UNIEL drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij.</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>Institucioni mbështet financiarisht aktivitetet studimore, kërkimore e shkencore të njësisë bazë dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022.</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022, organizimin e konferencave kombetare dhe ndërkombëtare në UNIEL.</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022.</i></p> | | |
| Konkluzione | Standardi përmbushet plotësisht. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi II.7 | |
| Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> | <p>Në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2020-24 theksohet se UNIEL synon të bëhet një institucion inovativ dhe lider, dixhital, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Një nga shtyllat e veprimtarisë së tij, UNIEL ia ka kushtuar punës kërkimore shkencore. Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit, ka në fokus organizimin dhe bashkëpunimin e njësisë të angazhuara në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme. Në Strategjinë e zhvillimit të institucionit theksohet se kërkimi shkencor do të orientohet drejt aplikimeve në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit dhe më gjërë duke synuar zhvillimin e inovacioneve. Koordinatorin për Kërkim krijon lidhjen ndërmjet Departamenteve dhe strukturave të kërkimit të aplikuar dhe koordinon zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si hartimin e strategjive, raportet, monitorimi dhe analizat, procedura, vlerësime etj, dhe aktivitetet si Konferenca dhe Botime, Evente, Projekte dhe Programe, Partneritet Ndërkombëtar, Ndërkombëtarizim dhe Promovim.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL., Neni 3 pika b.</i></p> <p><i>Evidenca 2.12, Vendim Departamenti për ndarjen e grup-lëndëve datë. 19.10.2020.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> | <p>GVJ konstaton se stafi akademik i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, ka lidhje dhe bashkëpunim efikas e të vazhdueshëm me qendrat e kërkimit e studimit dhe vlen të theksohet se disa prej anëtarëve të këtij departamenti janë po ashtu pjesë e tyre, të cilët angazhohen në projekte kërkimore aplikative, konsulenca, etj. Kjo mundëson që personeli akademik të pasurojë eksperiencën e vet akademike, por dhe të ndihmojë studentët të përfshihen në këto projekte.</p> <p>Evidencat tregojnë përfshirje jo aktive gjatë 2 viteve të pandemisë nga</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>ana e studentëve. Besojmë se institucioni do ta superojë këtë kohë jo efektive në ditët e vitet në vazhdim duke e patur kërkimin shkencor një sfidë e cila do ti shoqërojë drejt proceseve të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit.</p> <p>Në UNIEL po strukturohet Zyra e Ndërkombëtarizimit, me varësi të drejtë përdrejtë nga Rektori e cila në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit do e fokusojë aktivitetin e saj në :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rritjen e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes universitetit dhe institucioneve të tjera akademike, kërkimore, donatore dhe administrative. -Kordinimin dhe pjesë marrjen në mobilitete ndërkombëtare për kërkuesit shkencorë, stafin akademik, administrative dhe studentët. -Hartimin e jetësimin e programeve të përbashkëta të studimit. <p>Evidenca 1.15 Analizë vjetore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 2.13 Libri i abstrakteve të Konferencës Ndërkombëtare 2021.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> | <p>Në UNIEL janë një praktikë e zakonshme leksionet e hapura, ku të ftuar janë profesionistë të ndryshëm nga fusha që mbulon departamenti i edukimit fizik dhe sporteve ku pjesëmarrja e studentëve është mbresëlënëse.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka organizuar dy konferenca shkencore ndërkombëtare të cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët në arritjen e objektivave të programit të studimit. Konferenca e 5 dhe e 6-të ndërkombëtare e organizuar në prill të vitit 2021 në bashkëpunim me ASSA “Shkencat Sportive dhe Edukimi. Roli i tyre në zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Mirëqenies Sociale”.</p> <p>Evidenca 2.13 Libër Abstraktesh 5 prill 2019 dhe 6 prill 2021.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> | <p>Jemi të bindur pas shqyrtimit të evidencave dhe vizitave në institucion se Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor” siguron formimin e profesionistëve të aftë në tregun e punës kombëtar e më gjërë.</p> <p>Ky program studimi i hartuar në bashkëpunim me universitete të tjera partnere në projektin Tempus Speed është aprovuar nga AHESIS. Kjo përbën një garanci për cilësinë e përgatitjes së profesionistëve në tregun e punës jo vetëm kombëtar por edhe rajonal e më gjërë.</p> <p>Evidenca 2.19 https://ëëë.uniel.edu.al/bashkepunime/bashkepunime-nderkombetare/projekte-ku-ue-eshte-pjese/554-projekti-tempus-rr-44362</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësi përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së</p> | <p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit që mbulon dhe realizon këtë program studimi merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. Duke u nisur nga rekomandimet e bëra nga grupet e interesit Departamenti ka organizuar, përshtatur programet lëndore në përputhje me aktet ligjore në fuqi duke</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | <p>marrë në konsideratë edhe fondin e pyetjeve të provimit të liçensimit të mësuesve. Disa nga anëtarët e stafit akademik të Departamentit kanë marrë pjese në komisionin e provimit të liçensimit të mësuesve të edukimit fizik ndaj ata organizojnë edhe trajnime për të diplomuarit në mënyrë që provimi i liçensimit të jetë kurorëzimi me sukses e viteve të studimit.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL. Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL. Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL.</p> | | | |
| Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>). | <p>Në RVB theksohet se: Programi i studimit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” (120 kredite) në FSHE, është mbështetur në LAL 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", Neni 83, pika 2, ku shprehet se: "Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm, të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master" me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> <p>Po ashtu ai është në përputhje me të gjitha udhëzimet e vendimet e MAS si dhe rregulloret e studimit të institucionit.</p> <p>Pjesmarrja në projektin tempus nga viti 2013-2016 unifikoi këtë programi studimi për të gjitha universitetet partnere. Ky program studimi me të cilin aplikoi FSHE në projektin Tempus Speed është i detyrueshëm për të gjitha universitetet pjesmarrëse në projekt.</p> <p>Evidenca 2.16 Profesionet e Sportit: Arsimim, Punësim, Zhvillim në rajonin e Ballkanit.</p> | | | |
| Konkluzione | Ky standard përmbushet plotësisht. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|---|
| Standardi III.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e | Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në |

| | |
|---|--|
| <p>mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 535 orë mësimore - Seminare 640 orë mësimore - Laboratore/Praktika Sportive 300 orë mësimore - Praktikë profesionale 200 orë mësimore - Provë Finale 270 orë mësimore - Punë individuale e st. 1525 orë mësimore <p>Programi lëndor (syllabus) i secilës lëndë miratohet nga Senati Akademik dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Rektoratit të UNIEL përmes Fakultetit të Shkencave të Edukimit për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ndjek realizimin e aktiviteteve.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Neni 23 faqe 15.</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" Neni 17.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e muncësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | <p>Stafi akademik për të bërë harmonizimin e mësimdhënies ku ka diversitet në nevojat e studentëve, mbështetet edhe nga pedagogët që shërbejnë si koordinatore për çdo vit akademik si dhe nga struktura të tjera siç është Zyra në Shërbim të Studentëve.</p> <p>Personeli akademik orientohet dhe nxiet nga departamenti në fillim të çdo semestri të kontaktojnë me studentët që të diskutojnë me stafin akademik, disa elementë të procesit mësimor siç janë: pritshmëritë e tyre për programin dhe lëndën përkatëse; njohuritë e tyre paraprake për çështjet më të rëndësishme që trajton lënda përkatëse; mënyrën se si ata e vlerësojnë lidhjen e lëndës përkatëse me lëndë të tjera të programit mësimor; rëndësisë që ka lënda përkatëse për formimin e tyre të ardhshëm akademik apo si mësues të edukimit fizik dhe sporteve; specifika të stilit të tyre të të nxënit.</p> <p>Ndër objektivat strategjike të zhvillimit të UNIEL është matja e treguesve të performancës së personelit akademik, zhvillimi i një analize të veprimtarisë së personelit akademik, duke filluar nga njësia bazë, me analiza të detajuara e konkrete deri tek analizat në nivele të asamblesë së personelit.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIEL pika 4, 5.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> | <p>Në UNIEL është evidente që institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimit, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme.</p> <p>Nga ana tjetër, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ofron</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibël përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punë praktike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj.</p> <p>Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies përmes rritjes së kapaciteteve të stafit akademik, nxitet pjesëmarrja në trajnime, seminare apo konferenca të cilat kanë në fokus pikërisht cilësinë e mësimdhënies, përmes njohjes së metodave të reja të mësimdhënies, mënyrave të ndryshme të vlerësimit, etj. Të tilla aktivitete mbështetëse përfshijnë realizimin nga Departamenti i Informatikës të një sërë trajnimesh që janë ndjekur nga pedagogët e UNIEL.</p> <p>UNIEL mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personeleve akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre.</p> <p>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+.</p> <p>Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit akademik.</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Personeli akademik i këtij programi studimi angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve e moduleve të programit të studimit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës.</p> <p>Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit.</p> <p>Gjithashtu personeli akademik i programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor", përveç titujve dhe gradave ka edhe eksperiencën dhe kualifikime të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentet mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> <p>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik.</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Njësia bazë, Departamenti në mënyrë periodike konform legjislativitetit në fuqi bën rishikimin e gjithë programit mësimor me synimin për të harmonizuar njohuritë që studentët duhet të marrin nga i gjithë programi lëndor, duke shmangur mbivendosjet e informacioneve në lëndë të të njëjtit profil si dhe duke theksuar ato njohuri të cilat i shërbejnë përfundimisht të atyre dijeve të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me formimin e përgjithshëm të studentëve.</p> <p>Një nga metodat kryesore, që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës,</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>i cili kryhet në fund të çdo semestri nga ana e studentëve. Pyetëtori aktivizohet para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon ëorkshop-e dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga pedagogë të huaj.</p> <p>Sa më sipër rezultojnë se institucioni vlerëson dhe përmirëson vazhdimisht format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët, si edhe duke reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre.</p> <p>Gjatë muajit Mars 2021 është zhvilluar një pyetësor me një fokus grup me studentët e ciklit të studimit Bachelor dhe Master, të cilët kanë ndarë eksperiencën e tyre përgjatë viteve të studimit në UE, si dhe kanë dhënë sugjerimet e tyre. Nga të dhënat e përftuara rezultojnë se, studentët janë të kënaqur me nivelin e mësimdhënies së lektorit dhe vlerësimit të dijeve nga ana e tyre.</p> <p>Evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022.</p> <p>Evidenca 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarat. Studentët marrin pjesë në punë praktike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p>Ndërkohë një element shumë i rëndësishëm është pajisja e studentëve me njohuri për organizimin dhe zbatimin e lojrave sportive dhe sporteve individuale. Këto shihen si format kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve të edukimit fizik dhe sporteve.</p> <p>UNIEL ka në përbërje të saj strukturë ndihmës akademike me funksion koordinimin institucional, kërkimit shkencor dhe projektet. Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personleve akademike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në UNIEL funksionon zyra e Buletinit Shkencor, e cila është përgjegjëse për publikimin periodic të revistës. Në UNIEL është ngritur dhe funksionon Qendra e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET.</p> <p>Evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022.</p> <p>Evidenca 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL.</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| | Evidenca 3.3 Marrëveshja për krijimin e qendrës. | | |
| Konkluzione | GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p>GVJ konstaton se në UNIEL është prioritet që studentëve tu ofrohen metoda bashkëkohore të mësimdhënies, zhvillimi i të cilave parashikohet në syllabusin e lëndës / modulit që rishikohen çdo fillim viti akademik për të qënë i përditësuar me të rejat e fundit bashkëkohore.</p> <p>Gjithashtu UNIEL ka hartuar një udhëzues për mësimdhënien dhe të nxënëtit. Ky udhëzues është një material që ndihmon në zhvillimin e formave pedagogjike të stafit akademik dhe në përmirësimin e procedurave të mësimdhënies dhe të të nxënëtit.</p> <p>Duke qenë se që nga Marsi 2020 u kalua për shkak të pandemisë në mësimdhënie on-line UNIEL disponon një guidë instruktive për të kuptuarit, asimiluarit, mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies on-line.</p> <p>Kjo guidë gjykojmë se i ka mundësuar stafit akademik të UNIEL instrumenta, teknika dhe strategji të efektshme për mësimdhënien on-line, duke pasur në fokus dhënien e leksioneve, nxitjen e diskutimeve dhe reagimeve të studentëve për të nxënëtit e tyre, por dhe ka mundësuar zbatimin e teknikave efektive të vlerësimit, për nxitjen e të nxënëtit dhe matjen e rezultateve të studentëve.</p> <p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. UNIEL zbaton prej disa vitesh dhe sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSORE të financuar nga AADF.</p> <p>Evidenca 1.2-Rregullore Studimeve në UNIEL Neni 41,42,43,44,45,46.</p> <p>Evidenca 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE.</p> |
| <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në</p> | <p>Në UNIEL funksionon Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë e cila funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015, me Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Në rregulloren e kësaj njësie përcaktohen mënyrat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji 80/2015, Kodi i Cilësisë dhe Standartet e Cilësisë në Hapësirën Europiane të</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|--|
| <p>syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Arsimit të Lartë (HEAL) me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion. Monitorimi dhe vlerësimi kryhet duke zbatuar parimin e autonomisë institucionale.</p> <p>Në GVB theksohet: Lektori përgjegjës i lëndës/modulit në orën e parë të Seminarit Orientues njëh studentët me kriteret e lëndës dhe vlerësimin e tyre. Respektivisht studenti vlerësohet për pjesëmarrje dhe aktivizim në leksione e seminare, për punime të ndryshme krijuese, ese, punime me literaturë etj, të cilat përbëjnë 20% të vlerësimit përfundimtar, testimi i ndërmjetëm përbën 35% të vlerësimit përfundimtar dhe provimi i sezonit të provimit (Testim Përfundimtar) përbën 45% të vlerësimit përfundimtar në total. Për lëndët me ushtrime (mësime praktike) duke ju përmbajtur elementëve të mësipërm të kësaj pike vlerësimi do të bëhet: a) Vlerësimi i studentit në raportet: 65% pjesa e testimit praktik, 35% pjesa e testimit teorik të lëndës; b) Studenti duhet te ketë marrë mbi 45% të pikëve si për pjesën teorike ashtu edhe ate praktike.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore Studimeve në UNIEL Kreu 5, Neni 40, pika 4) Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2.</p> | | |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit Kreu i V, Vlerësimi i Studentit, Neni 19 – Procedura dhe kriteret e vlerësimit thuhet: “Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.</p> <p>-Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</p> <p>-Kur provimi është vetëm me shkrim:</p> <p>-Provimi zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin është drejtuesi i departamentit apo një person i autorizuar prej tij.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë: të vazhdueshme (seminaret, seminare praktike), të ndërmjetme (provime të ndërmjetme) të cilat përcaktohen prej titullarit të lëndës/modulit në programin/syllabusin lëndor dhe provimi përfundimtar në sezonin përkatës të provimeve.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore Studimeve në UNIEL”, Neni 42.</p> <p>Evidenca 1.8 Rregullore e Program Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”, kreu 5 Neni 19 ”)</p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>Ky standard përmbushet plotësisht.</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i</p> | <p>Vlerësimi i një lënde mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë</p> |

| | |
|--|--|
| <p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri F. Në rregulloren e FSHE-së është përcaktuar se vlerësimi përfundimtar i studentit është rezultat i tre përberësve: vlerësimi i vazhduar për lëndët e cilësura provim përben 20-40% të vlerësimit përfundimtar, vlerësimi i ndërmjetëm gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e lëndës ose të modulit dhe vlerësimi me provimin përmbyllës. Përcaktimi i raportit mes tre përberësve të vlerësimit përfundimtar (të vazhduar, të ndërmjetëm dhe i provimit) sipas parashikohet në rregulloren e fakultetit, evidentohet në programin (syllabusin) e çdo lënde/moduli.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore Studimeve në UNIEL, Neni 41,42,43,44,45. Evidenca 1.7 Rregullore FSHE Neni 39; Appendix Tabela 15, 15/1, 15/2.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>Nga vizita në institucion konstatojmë që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në regjistrin përkatës elektronik.</p> <p>Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarat, ushtrimet, praktikat sipas përcaktimit të Rregullores për funksionimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si google classroom ku janë përfshirë edhe module të vlerësimit elektronik. Në projektet për të ardhmen parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies.</p> <p>GVJ konstaton se UNIEL është bërë pjesë e programit CleanScore në 28.12.2020 ashtu si shumë IAL homologe ku korigjimi i testeve bëhet elektronikisht në kohë rekord gjë e cila ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me notë.</p> <p>Evidenca 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE.</p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, kontrolli i dijeve bëhet siç është parashikuar në syllabusin e lëndës, me provim me shkrim, me gojë apo të kombinuar. Provimet e ndërmjetme zhvillohen gjatë semestrit në periudha kohore proporcionale me zgjatjen e lëndës, ndërsa provimi përfundimtar zhvillohet në sezonin e provimit. Tezat e testeve të ndërmjetme dhe të provimit përfundimtar hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga së paku dy pedagogë. Komisioni kryesohet nga titullari i lëndës. Notat</p> |



| | |
|---|--|
| | <p>përfundimtare të vlerësimit të studentit shënohen me shifër dhe me shkrim në procesverbalin e provimit të kursit që firmoset nga anëtarët e komisionit, nga kryesekretarja e Sekretarisë Mësimore dhe Dekani.</p> <p>Evidenca 1.2-Rregullore Studimeve në UNIEL Neni 41,42,43,44,45 ,46. 1);</p> <p>Evidenca 3.7 Model Propozimi i Komisionit të Provimeve.</p> |
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi.</p> <p>Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogëve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.</p> <p>Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit.</p> <p>Evidenca 1.2-Rregullore Studimeve në UNIEL Neni</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>UNIEL, nëpërmjet rregullores mbi disiplinën e studentëve, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmblyëse.</p> <p>GVJ gjykon se UNIEL ka mundësitë që të blejë një program me pagesë i cili mundëson kontrollin e plagjiaturës si tek stafi akademik ashtu edhe tek temat e diplomës së studentëve kryesisht të Masterit Shkencor por edhe tek temat e këtij programi studimi Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor". Nuk lejohet përdorimi i celularit si dhe i çdo aparature tjetër audiovizive. Në rast se studenti kapet me kopje nga lektori apo nga asistuesi i tij, studenti ndërpret provimin dhe vlerësohet me notën katër, dhe për këtë vihet në dijeni përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Evidenca 1.2 - Rregullore Studimeve në UNIEL Neni Neni 47, pika 2/e.</p> |
| <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Në dokumentacionin dhe evidencat e shqyrtuara afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit.</p> <p>Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, në përgjithësi maksimalisht 10 ditë pas periudhës së provimit përfundimtar.</p> <p>Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.</p> <p>Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe kryesekretari.</p> <p>Evidenca 1.2 - Rregullore Studimeve në UNIEL Neni Neni 48.</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të</p> | <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|--|
| <p>drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>ne universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në sekretarinë mësimore në bashkëveprim edhe me Dekanen e studentëve me anë të një formulari të veçantë, brenda 3 ditëve pas shpalljes së notave përfundimtare por para shënimit të notës në Regjistrin e arritjeve akademike.</p> <p>Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jo zyrtare para se t'i regjistrojë të njëjtat, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve për shpjegim lidhur me notat e vendosura.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore Studimeve në UNIEL Neni 46.1.</p> | | |
| <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara.</p> <p>Në rastet kur pedagogu refuzon ndryshimin ose nuk kontaktohet dot, studenti bën një ankimim dhe ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet e arkivohet në sekretarinë mësimore.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore Studimeve në UNIEL Neni 46.1.2</p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ gjykon që ky standard përmbushet plotësisht.</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |



Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë.</p> <p>Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në studimet në vazhdim, për ata studentë që kanë rezultatet më të larta dhe kanë synime për më lart si psh. Master Shkencor.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet punëve të pavarura dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, aktivitete të larmishme studentore etj.</p> <p>GVJ nga takimet me studentët konstatoi vëmëndjen e vazhdueshme të</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>institucionit sidomos për studentët e spikatur në sport sepse vërtet ata janë elemente të fuqishme marketingu për institucionin.</p> <p>Objektivat formuese të programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” përfshijnë profilin kulturor dhe profesional të studentit në përfundim të këtij programi, ku theksohet përgatitja dhe formimi i mësuesit të EF e Shëndetësor me njohuri, aftësi e të kuptuar të thellë të EF e Shëndetësor.</p> <p><i>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” kreu 2, Neni 6.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>GVJ konstaton se 12 ECTS ose 10% e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Programi përmban lëndë si: Gjuhë e huaj për qëllime specifike, Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në edukim, Statistikë e avancuar dhe kërkim shkencor etj.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” kreu 2, Neni 6, 7.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde përmblihen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Në analizat e departamentit është praktikë e zakonshme pune që të shqyrtohet gjerësisht: niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve; sfidat në arritjen e tyre; efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie; përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde/moduli përshkruhen përveç të tjerave edhe kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të çdo lënde/moduli. Në varësi të tipologjisë së lëndës/modulit përshkruhen dhe kompetencat e të nxënësve, me synim aftësimin e studentit që të kuptojë, analizojë, sintetizojë dhe të praktikojë njohuritë e përftuara nga lënda. Nivelin e përvetësimit të këtyre kompetencave, lektori i lëndës është në gjendje ta evidentojë edhe gjatë procesit të zhvillimit të lëndës deri në detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e studimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i></p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde përmbliidhen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Në analizat e departamentit është praktikë e zakonshme pune që të shqyrtohet gjerësisht: niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve; sfidat në arritjen e tyre; efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie; përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë.</p> <p>Studentët që ndjekin programin e studimit Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" pajisen me njohuri e kompetenca si: mësues që kupton se nxënësit kanë nevoja individuale dhe i'u përgjigjet atyre, mësues me aftesi profesionale që të planifikojë, shpërndajë e të vlerësojë me efikasitet kurrikulën, menaxhim efikas i klasës dhe aftësia për të menaxhuar nxënës të ndryshëm, zotësi për të mbështetur të nxënë, progresin e zhvillimin e nxënësve, etj. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP" u kushton rëndësi të veçantë metodologjisë së mësimdhënies, ku për një mësimdhënie cilësore ndërthur metoda mësimdhënieje bashkëkohore me qëllim që çdo student të plotësojë nevojat dhe kërkesat e veta.</p> <p>Në RVB theksohet: personeli akademik shfaq një frymë demokratike e bashkëkohore me studentët e këtij cikli studimi, duke ju garantuar atyre cilësi mësimdhënie e mësimnxënie me qëllimin e të qënurit mësues me vlera etike dhe profesionale në profesionin e tyre.</p> <p>Evidenca 2.14 Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Në UNIAL, Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon ëorkshope mbi të rejat e fundit në fushat e tyre të ekspertizës, si dhe zhvillon leksione në institucione të ndryshme.</p> <p>Studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Stafi akademik i inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre si mësues të edukimit fizik, por edhe në fushën e akademizmit.</p> <p>Stafi akademik kryesisht ai me tituj e grada zhvillon "open inovation" në lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë. Duhet theksuar se stafi akademik i brendshëm dhe ai me kontratë në këtë program studimi janë nga personalitetet më të spikatura në ekspertizat e tyre</p> |

| | <p>duke i rritur dukshëm standartet akademike dhe cilësinë e kësaj diplome.</p> <p>Evidenca 2.13 Libri i abstrakteve të Konferencës Ndërkombëtare 2021.</p> <p>Evidenca 6.4 Lista e Personelit të ftuar të angazhuar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.</p> | | | | | | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|--|--|---|
| <p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p> | <p>GVJ konstaton pas takimit me studentët se ata inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, me anë të Dekanatit të Studentëve, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht sic është kredia me zero interes për studimet.</p> <p>Në RVB theksohet: Masteri Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” u ofron mundësi të shumta studentëve të cilët dëshirojnë të jenë partnerë e bashkëpunues të vyer në kërkime shkencore realizuar edhe nga personeli akademik. FSHE-ja dhe personeli akademik i fton studentët të jenë bashkëpunëtorë në studimet e tyre, duke e mbështetur fort idetë e tyre inovative. FSH-ja në konferencat ndërkombëtare që zhvillon fton të gjithë studentët të sjellin abstraktet e tyre, botimet e tyre shkencore në sesionin përkatës të konferencës, duke i mbështetur financiarisht ata.</p> <p>Evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022), publikimin në revistën periodike Buletini Shkencor.</p> <p>Evidenca 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL.</p> | | | | | | | | |
| Konkluzione | GVJ del në konkluzionin se ky standard përmbushet plotësisht. | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| | |
|--|---|
| Standardi III.5 | |
| Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> | <p>GVJ konstaton se procedura për provimin final para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit uniel.edu.al nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p>UNIEL ka hartuar paketën e detyrimeve përmbyllëse ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Kjo paketë përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të konsultimeve, të monitorimit, të vlerësimit të punës dyvjeçare;</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të programit të studimit.</p> <p>Për të fituar diplomën Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” studenti duhet të ketë marrë 120 kredite dhe të marrë provën finale që realizohet me provim përmbyllës ose temë diplome.</p> <p>Në Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë studentët, nota e të cilëve për vitin e parë akademik është nën 8 (tetë), ndërsa studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8 (tetë) pas mbarimit të vitit të parë akademik, fitojnë të drejtën të mbrojnë Temë Diplome nën udhëheqien shkencore të lektorit.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Kreu 8, Neni. 60,62,63.</p> <p>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor.</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Informacioni dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në UNIEL është i publikuar. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato tek studentët në fillim të semestrit.</p> <p>Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore.</p> <p>Gjithashtu për departamentin është shumë e rëndësishme puna paraprake me studentët, konsultimi i pyetjeve dhe takimet sqaruese me titullarët e lëndëve përpara provimit të përgjithshëm përfundimtar apo mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Çdo lektor përgjegjës i lëndës/modulit, paraqet në Departament Programin e tematikave se ku do të mbështetet studenti, si dhe fondin e pyetjeve përkatëse, përzgjedhëse për Provimin e Formimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Referuar Temave të Diplomës, Udhëheqësi Shkencor është në mbikqyrje të vazhdueshme dhe mbështetës për studentin deri në përfundimin dhe mbrojtjen me sukses të Temës së Diplomës.</p> <p>Evidenca 3.8 Model Program të tematikave mbështetese për studentin që i nënshtrohet Provimit të Formimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</p> <p>Evidenca 1.15 Analizë Vjetore e Departamentit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të</p> | <p>Provimi final është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre master profesional. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Komisioni i Departamentit përgatit provimin final bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Në fondin e pyetjeve të Provimit të Formimit të Përgjithshëm Përfundimtar përfshihen të gjitha njohuritë e marra përgjatë dy viteve akademike në të gjitha lëndët/modulet e përfshira në këtë program studimi, mbi të cilat realizohet testimi i njohurive të studentëve që përfundojnë këtë program studimi dhe vlerësimi përkatës i këtyre njohurive.</p> <p>Evidenca 3.9 Miratim Dekanati, i Propozimit të Departamentit Nr. 195, dt. 15.07.2021 mbi Komisionet e Administrimit dhe Korrigjimit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo njëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentave dhe evidencave GVJ konstaton se në UNIAL për të fituar diplomën e studimeve Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale (provim i përgjithshëm përfundimtar).</p> <p>Në paketën e provës finale gjenden: udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie.</p> <p>Komisioni i Provës Finale që ngrihet për vlerësimin e studentëve në provimin final të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, bazohet në procedurat e përshkruara hollësisht të paketës së provës finale.</p> <p>Çdo personel akademik i përfshirë në këtë program studimi orienton studentët në përzgjedhjen e temës së diplomës me qëllim për të qenë sa më pranë interesave dhe nevojave profesionale të studentit.</p> <p>Studenti gëzon të drejtën e plotë e të lirë për të përzgjedhur temën që është më afër nevojave të tij profesionale, si dhe udhëheqësin e temës së tij të diplomës. Pas miratimit nga përgjegjësi i departamentit, të temës së diplomës së studentit dhe udhëheqësit shkencor të tij, ky i fundit përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollon puna e bërë sipas programit të miratuar. Udhëheqësi i Temës së Diplomës në bashkëpunim me studentin përgatit programin e punës së tij, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, Kreu 8, Neni 62.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme.</p> <p>Pegagogu udhëheqës mban kontakte të vazhdueshme me studentin diplomant 2-3 orë në javë dhe e asiston edhe në laborator apo mjediset sportive për realizimin e matjeve apo testeve.</p> <p>GVJ rithekson që në zbatim të Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë në</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Republikën e Shqipërisë Neni 73 theksohet se: “Studentët në programet e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome”.</p> <p><i>UNIAL tua mundësojë këtë të drejtë të përcaktuar me ligj studentëve ekselentë nëpërmjet rregulloreve ku përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtë studentit duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.</i></p> <p>Për të stimuluar punët në laboratore si për studentët dhe pedagogët departamenti duhet të montojë dhe vendosë në gjëndje pune dy paisje shumë moderne të përfutuara nga Projekti Tempus Speed; Trade Mill dhe Platforma Leonardo e matjeve të balancës apo ekuilibrit.</p> <p>Evidenca 2.4 Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022</p> |
| <p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>GVJ konstaton se Komiteti Shkencor i programit përkatës i propozon përgjegjësit të njësisë bazë Komisionin e Vlerësimit me një përshkrim të shkurtër për anëtarët e tij. Titullari i njësisë kryesore miraton Komisionin e Vlerësimit me propozimin e njësisë bazë. Komisioni përbëhet nga 3 pedagogë ose specialistë të fushës ku njëri është oponenti. Ata duhet të jenë me tituj dhe grada.</p> <p>Për vlerësimin e diplomës anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh këto kritere: demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; dobinë e punimit; cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit); paraqitjen e qartë dhe formimin e një tërësie koherente;(respektimi i kërkesave të formatit dhe kërkesave teknike); cilësinë e prezantimit.</p> <p>Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL Kreu 8, Neni, 63, 65.</p> <p>Evidenca 1.7 Rregullore e Studimit e Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Në përfundim të studimeve, në programin e studimit Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 ECTS dhe provimin final apo nëse do të mundësohej mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin.</p> <p>Zyra e Regjistrimit të Universitetit pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të licensuara dhe të aprovuara nga MAS në përputhje me aktet rregulluese.</p> <p>Diploma Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” është regjistruar në Rregjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në MAS, në Qendrën e Shërbimeve</p> |

| | | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|--|
| | <p>Arsimore Urdhër Nr. 13291/1, dt. 05.01.2018 dhe me Numër unik Identifikimi 001688.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL Neni 61.</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Urdhër MASR Nr. 13291/1, dt. 05.01.2018 për Rregjistrimin e Formes së Diplomës për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” të Universitetit të Elbasanit.</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.</p> <p>UNIEL ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> <p><i>Evidenca 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".</i></p> | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ shprehet mendimin që ky standard përmbushet plotësisht.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | |
| | | | X | |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p> | <p>Në Planin Mësimor të Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”, në tipin e veprimtarisë e Lëndëve Plotësuese është parashikuar ngarkesa mësimore/akademike të Praktikës Profesionale në Edukim Fizik, me 8 kredite dhe 300 orë mësimore, që zhvillohen nga studentët nën drejtimin e lektorit përgjegjës.</p> <p>UNIAL për realizimin në institucionet arsimore të praktikave profesionale në sistemin parauniversitar në kuadër të programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore Elbasan, ku UNIAL propozon shkollat përkatëse ku do të zhvillohet praktika profesionale, përcakton Lektorin Përgjegjës, si dhe listën e studentëve praktikantë.</p> <p><i>Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Plani Mësimor i Programit të Studimit “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format</p> | <p>Mësimdhënia në UNIAL realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” kanë në dispozicion infrastrukturën e</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimim më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e biologjisë e kimisë, si dhe në praktikat profesionale. Praktika profesionale parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional. <i>Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i> | | | |
| Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | UNIEL nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore të Qytetit të Elbasanit, ku FSHE-ja propozon shkollat përkatëse të arsimit parauniversitar ku do të realizohet praktika profesionale, përcakton Lektorin apo Mentorin Përgjegjës, si dhe listën e studentëve praktikantë për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore parauniversitare, në kuadër të programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”. Praktika Profesionale në EF dhe atë Shëndetësor ka si objekt formimin e aftësive të studentëve për shfrytëzimin e njohurive shkencore pedagogjike, sportive dhe profesionale, për të promovuar me efikasitet personalitetin e rolin e mësuesit të Edukimit Fizik në shkollë. Mentorimi i studentëve duhet paguar dhe kjo gjë do të rriste efikasitetin dhe cilësinë e punës nga ana e mentorëve në drejtim të tutorimit të studentëve gjatë praktikave profesionale. <i>Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i> <i>Evidenca 2.15 Model Syllabusi i praktikës profesionale.</i> | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ e konsideron të përmbushur plotësisht këtë standart.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|--|--|
| Standarti IV.1 | |
| Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, | GVJ ka analizuar dokumentacionin të paraqitura në evidence si dhe CV-të e personelit akademik, dhe ka konstatuar se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi, në departamentin e Edukim Fizik dhe Sporte, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i |

| | |
|--|---|
| <p>përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'.</p> <p>Aktualisht, njësia bazë, përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në të cilin ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademike 7 pedagogë me kohë të plotë. Në kategorinë "Profesor" Prof. As. (2PAE), si dhe me grada shkencore "Doktor" (4 PAE) dhe 1 pedagog me Master Shkencor, si dhe 1 staf ndihmës mësimor. Gjithashtu, kjo njësi ndërvepron me departame e tjera ndihmëse siç janë Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies në të cilin ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademike 8 pedagoge. Në këtë program ushtrojnë aktivitetin e tyre akademik (2 PAE) të kategorisë Profesor dhe (5 PAE) të kategorisë "Profesor të asociuar, si dhe me titullin Docent (1 PAE). Departamenti i Psikologjisë 7 pedagogë, në kategorinë "Profesor" (3 PAE), si dhe me grada shkencore "Doktor" (4 PAE). Ndërsa numri i personelit PAK është 6 persona, për vitin 2019. 2020 dhe për vitin 2021 7 persona nga të cilët (3PAK) të kategorisë "Profesor", (2PAK) të kategorisë "Profesor i asociuar" dhe (1PAK) i kategorisë "Doktor").</p> <p><i>Evidenca 6.4 Lista e Personelit të Ftuar të angazhuar në fakultet.pdf</i> <i>Evidenca 6.4 Lista e Personelit të Ftuar të angazhuar në FSHE.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> | <p>Personeli akademik në bazë të marrëveshjes për kohën e punës vjetore të personelit mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p>Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" si disiplinat e formimit bazë, karakterizues, ndërdisiplinor, si dhe disiplinat plotësuese janë tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë Kryesore. Respektivisht lëndët me natyrë mjekësore mbulohen nga PAE i FSHMT, lëndët me natyre psikosociale, teoriko-metodologjike mbulohen nga PAE i Departamenti i Metodologjive të Mësimdhënies, Departamenti i Psikologjisë. Lëndët me natyrë sportive mbulohen nga PAE i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit.</p> <p><i>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 lëndët dhe ngarkesa përkatëse.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me</p> | <p>Personeli akademik i rregulltë dhe i angazhuar nënshkruajnë kontratën me Universitetin të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, është i pandryshueshëm për të gjithë periudhën e parashikuar për akreditim në programin Master |

| | |
|--|---|
| sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | <p>Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor’.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik me kohë të pjesëshme, për vetë natyrën specifike të këtij programi, përgjithësisht, është i pandryshueshëm për të gjitha vitet akademike të parashikuara në akreditim. <p>Insitucioni garanton dhe të dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, si dhe qëndrueshmërinë dhe detyrimet financiare.</p> <p>Evidenca 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022. Evidenca 6.4 Lista e Personelit të ftuar të angazhuar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Institucioni ndjek procedurat rekrutimi dhe vlerësimi sipas kritere të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha njoftimet publikohen duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen si dhe kërkesat e programit të studimit.</p> <p>Nga vizta e GVJ-së në institucion dhe zyrat e BNJ-së, në periudhën kohore që është aktivizuar programi i studimi Master Profesional Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor’, procedurat e rekrutimit, janë të fokusuar në kriteret e përgjithshme dhe ato specifike.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kriteret e përgjithshme hartohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore -Kriteret specifike parashikohen në Njësinë bazë, Departamenti i Interpretimit. <p>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL. Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmëskademik. Evidenca 4.4 Rregullore e rekrutimit të personelit administrative.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, përcakton organizimin e brendshëm akademik dhe administrativ sipas udhëzimeve për strukturat e brendshme akademike dhe administrative. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmëskademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.11 Struktura organizative e UNIEL.</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë angazhimin</p> |

| | |
|--|---|
| <p>akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konsatohet se të dhënat mblidhen, ruhen dhe përditësohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, - angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, - angazhimin e çdo anëtari të personelit ndihmës dhe administrativ. - Personeli akademik me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar, aplikon çdo fillim viti akademik. - Kriteret e konkurrimit shpallen publikisht sipas legjislacionit në fuqi. <p>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse.</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>Duke u bazuar në marrëveshjet për praktikën profesionale me shkolla, Institucioni vë në dispozicion personelin e duhur për kryerjen e praktikave.</p> <p>Studentët e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor”, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë, duhet të realizojnë praktikën mësimore pranë institucioneve të ndryshme që gjenden në listën e përcaktuar në dokumentacion (shiko evidencën .1.14)</p> <p>Me krijimin e Bordit Këshillimor të Biznesit, studentët janë përfshirë në aktivitete të shumta informuese për ti njohur ata me kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Evidenca 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave. Evidenca 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022.</p> |
| <p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA për praktikën profesionale ku praktikën mësimore studentët I realizojnë në shkolla. Marrëveshja parashikon angazhimin e një pedagogu, përfaqësues të njësisë bazë në mbikëqyrjen e praktikës, si dhe një përfaqësues të institucionit pritës. Përfaqësuesi i institucionit pritës mbikëqyr dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikëqyrur .</p> <p>Evidenca 1.2 Regullore e Studimeve në UE “Aleksandër Xhuvani”, Neni 35, pika 2.</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit</p> |

| | | | |
|--|--|------------------------------|---|
| | <i>akademik, si dhe realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. GVJ, kostaton se Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani' e përmbudh plotësisht standatrin IV.1</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | |
| | | | X |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Gjatë vizitës së hapësirave fizike në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', GVJ konstatoj se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim/leksionet dhe ushtrimet e sportit të studentëve. Institucioni siguron mjedise specifike për orët e mësimit individual, mjedise për mësim në grupe të mëdha.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka infrastrukturë bashkëkohore në kuadër të një mësimdhënie cilësore për studentët, specifikisht për studentët e departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit . Institucioni është i pajisur me salla leksione me sipërfaqe 1511 m2/student, klasa për seminare 272.5 m2/student, laboratorë m2/student, salle interneti 50 m2/student, sallë për bibliotekë 196 m2/student, zyrë informacioni për studentët 25 m2/student, mjedise sportive 1350 m2/student, palestrër, pishinë olimpike, mjedise shlodhëse, nyje hidrosanitare për studentët 100 m2/student.</p> <p><i>Evidenca 4.7: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit.</i></p> <p><i>Evidenca 4.8: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratoreve të Fakultetit.</i></p> <p><i>Evidenca 4.9: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', GVJ konstaton se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve. Auditorët e lëndëve teorike janë të pajisura me mjete elektronike dhe pajisje teknologjike. Mjediset mësimore të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', biblioteka, laborator i informatikës dhe sallat e leksioneve, nëpërmjet të cilës realizohet procesi mësimor teorik janë të pajisura me kompjutera laptop, desktop, monitor dhe projektor. Nëpërmjet përdorimit të teknologjive bashkëkohore garantohet përdorimi i metodologjive të mësimdhënies e mësimnxënies bashkëkohore.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Evidenca 4.9: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, GVJ konstaton se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve.</p> <p>Në departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporte, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, gjenden Laboratori i Biomekanikës, Anatomisë, Fiziologjisë, Biokimik, Laboratori i Informatikës dhe Linguistikës, Laborator i Fiziotherapisë, Laboratori i Psikologjisë, për përdorim didaktik mësimor si dhe punë kërkimore shkencore. Laboratorët janë të pajisur me instrumentat përkatës, dhe secili laborator ka staf ndihmës akademik, për mbarëvatjen më të mirë të tyre dhe procesit mësimor. Dy palestrat dhe ambjentet ndihmëse të tyre përdoren për veprimtari mësimore me karakter sportiv, për stafin dhe studentët.</p> <p>Evidenca 4.8: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, GVJ konstaton se ka hapësira për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve në laboratore të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Laboratori i Informatikës përmban mjetet e teknologjisë së informacionit bashkëkohore për një mësimdhënie efektive. Institucioni ka siguruar një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale të instaluar në kompjuterat që gjenden në këtë laborator janë të licensuara, ku përfshihen Programi Statistikor SPSS Version 20, si dhe Paketa Office, Exel, Ëord etj.</p> <p>Evidenca 4.9: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p> | <p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në evidencë, institucioni ka marrëveshje me institucionet për kryerjen e lëndëve të sportit dhe praktikave sportive.</p> <p>Nga vizita GVJ-së, në ambientet fizike në institucion, konstatohet se institucioni garanton kapacitete dhe mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për profilin e departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit, si palestra e Edukimit Fizik dhe Sportit multifunkionale 1240 m², salla e Lojërave me dorë ka një sipërfaqe prej 220 m², salla e rekreacionit 200 m², fusha e minifutbollit me sipërfaqe 300 m².</p> <p>Ambientet shfrytëzohen nga studentët gjatë procesit mësimor, por edhe jashtë tij për ushtrim individual/profesional (çdo ditë të javës nga e Hëna në Premte, ora 14: 00 — 15:00, nëpërmjet një kërkesë drejtuar njësisë kryesore, ku pas miratimit të kërkesës, i përcjelllet Administratorit , i cili ngarkon me detyrën përkatëse Drejtorinë e</p> |

| | <p>Shërbimeve Mbështetese). Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” për realizimin e praktikave profesionale praktike, si dhe veprimtarive të tjera praktike e realizojnë sipas orarit mësimor.</p> <p><i>Evidenca 4.8: Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</i> <i>Evidenca 4.17: Kontrate Qiraje Nr1221/7prot., datë 19.07.2018</i></p> | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Konkluzione | <p>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për zhvillimin e lëndëve specifike të këtij programi studimi, si dhe përmbushur plotësisht këtë standart.</p> | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.3 | |
| Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Në bibliotekë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, e cila është pjesë e bibliotekës së UE-së ndodhen aktualisht 2835 kopje (të printuara dhe në systemin JSTORE)..Pavarësisht se fondi i bibliotekës së universitetit të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka ka rreth 27 mijë tituj dhe me shumë se 100 mijë kopje si libra, gazeta, revista, dizertacione, mikro-teza, materiale audio-vizuale, atlase ej, gjatë vizitës se GVJ-së në ambientet e bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit, konstatohet se ka një numër relativisht të vogël botimesh të printuara, specifikisht mbulon vetëm nevojat e litreaturës kryesore të departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit.</p> <p><i>Evidenca 2.8: Fondi i librit.</i> <i>Evidenca 2.7: Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> | <p>Nga vizita e GVJ-së, si dhe nga analizimi I dokumentacionit përkatës, konstatohet se njësia bazë bën raportime në lidhje me përditësimin e literatures me botime të viteve të fundit. Fondi i bibliotekës pasurohet me literature bashkëkohore duke marrë në konsideratë syzjerimet e stafit akademik për titujt dhe fusha të veçanta apo specifike të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.8: Fondi i librit.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, konstatohet se personelit administrativ punon me përkushtim për të ofruar studentëve shërbimet e duhura. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore të librave të printuar ose librarive elektronike, duke garantuar mundësinë e përdorimit nga të</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>gjitha programet e studimit.</p> <p>Evidenca 2.8: Fondi i librit.</p> <p>Evidenca 2.7: Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në ambientet fizike, konstatohet se biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, përmban materiale të shumëllojshme si: libra, gazeta, revista, dizertacione, mikro-teza, materiale audio-vizuale, atlase etj. Një pjesë e këtyre botimeve, mbulojnë kërkesat e literaturës kryesore të departamentit, specifiku të programit Master Profesional, Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor. Por duhet të pajisen me botime të tjera të këtij profili, për të përmbushur edhe kërkesat e literaturave ndihmëse të lëndëve përkatëse.</p> <p>Evidenca 2.8: Fondi i librit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Në biblioteken e UE-së ka 309 vende leximi si dhe biblioteka është e pajisur me kompiutera në ndihmë të lexuesve. Ndërsa në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, gjenden një numër i vogël i kompjuterave.</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, konstatohet se institucioni garanton e krijon kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> <p>Evidenca 2.8: Fondi i librit.</p> |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p> | <p>Nga vizita e GVJ-së, konstatohet se nëpërmjet një projekti të bashkëfinancuar nga AKKSHI dhe Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', biblioteka është duke iu nënshtruar procesit të dixhitalizimit të saj, dhe pasurimit me programe akademike kompjuterike të tjera.</p> <p>Evidenca 4.10: Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL.</p> |
| <p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se ambientet e bibliotekës së Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', vihen në dispozicion të plotë të studentëve, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>Evidenca 4.11: Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL.</p> |
| <p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit,</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se personeli administrative i Bibliotekës raportojnë periodikisht për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët po ashtu raportojnë edhe për shfrytëzimin e sallave. Në mënyrë periodike raportohet lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave</p> |

| duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik. | | | | |
|--|---|----------------------|-----------------------|---|--|
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukture për bibliotekën, por për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional 'Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor', ka relativisht pamjaftueshmëri për plotësimin e literaturave ndihëmes. Për këtë arsye, institucioni, e përmbush kryesisht këtë standart...</i> | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | X | |
| Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | |
| X | | | | | |

Standardi IV.4



Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe nga vizita në ambientet fizike të institucionit, GVJ konstaton se Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani' disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p>EMS është Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, i cili ofron funksionalitetet e nevojshme tek sekretaritet, administrata, ashtu si dhe përdoruesve fundor (studentëve, stafit akademik, etj.), në mënyrë që të menaxhojë të gjithë ciklin akademik të studentit: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, transferimet nga njëri universitet në tjetrin vlerësimet dhe diplomimet.</p> <p><i>Evidenca 4.12: Rregullorja EMS</i></p> |
| Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | <p>Përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve EMS në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', zbatohen politika të ruajtjes së të dhënave dhe përpilimi të statistikave me të dhënat e studentëve nga ana e sekretarisë mësimore si dhe regjistrave fizik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se, për anën akademike, sistemi EMS administron informacion dhe aktivitetin e lektorit, konkretisht në hedhjen e frekuentimeve të lëndëve/moduleve për studentët ndjekës të programit të studimit, sipas grupit dhe kursit përkatës.</p> <p>Ndërsa për anën administrative, sekretaria mësimore, ruan informacionet rreth pranimit dhe regjistrimit të studentëve, menaxhimit</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>të dhënave për studentët që do të diplomohen, si dhe ruajtjen dhe arkivimin e provimeve, notave etj.</p> <p>Marrëveshja e Konfindecialitetit, zbatohet tërësisht, nëpërmjet ruajtjes së anonimitetit dhe dhënies së informacioneve të personat e paautorizuar.</p> <p>Evidenca 1.13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Institucioni siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë studentët dhe personelin akademik duke përdorur emailin e postave nga Sekretaria Mësimore si dhe sistemin EMS, i cili siguron akses në informacionet dhe dokumentet, për personelin akademik dhe administrative. Lektori pas zhvillimit të provimit paraqet rezultatet e studentëve, ku nota e provimit studentëve paraqitet online nëpërmjet aksesimit individual për secilin student, të cilët njihen me rezultatin e provimit në kohëshumë të shpejt. Procesverbalet online qëndrojnë të pa printuara për 6 ditë dhe nëse nuk ka kundërshtime nga studentët, lektori i printon, i firmos dhe i dorëzon në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Studentët kanë akses të kryejnë çdo veprimtari të mundshme, prenotim provimesh, rregjistrim në provime, printime të formulareve të ndryshëm etj.</p> <p>Evidenca 4.16 Manuali i përdorimit të sistemit EMS. Evidenca 4.12 Regullorja EMS.</p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve EMS, titullari i lëndës dhe studentët mund të realizojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>Titullari i lëndës paraqet të dhëna mbi frekuentimin e seminareve dhe ushtrimeve të studentëve, duke paraqitur specifika si analizë të realizimit të eseve, detyrave të kursit dhe gjithçka lidhur me lëndën/modulet frekuentues nga studentet. Gjithashtu, në hapësirën e tij "Profili i Pedagogut", titullari i lëndës shënon dhe vendin dhe oraret e takimit me studentët.</p> <p>Evidenca 4.16: Manuali i përdorimit të sistemit EMS. Evidenca 4.12: Regullorja EMS.</p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>GVJ konstaton se, Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, EMS, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit të personelit akademik, ku frekuentimi i lëndëve, vendosja e notës nga lektori, i'u transmetohet studentëve në faqen e tyre personale në sistemin EMS.</p> <p>Procesi i ngarkimit të lëndëve/moduleve, lista e studentëve pjesëmarrës në provim etj, nga Dega e Informacionit dhe Rregjistrimit të Studentëve, përcillet automatikisht direkt në sistemin e menaxhimit të titullarit të lëndës.</p> <p>Evidenca 4.16: Manuali i përdorimit të sistemit EMS. Evidenca 4.12: Regullorja EMS.</p> |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen</p> | <p>GVJ konstaton se, në faqen zyrtare të Institucionit Universiteti i</p> |

| me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani' realizon publikimin e informacioneve që lidhen me programin e studimit, me personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme. Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB. | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Konkluzione | <i>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe në evidencat, konstaton se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit EMS, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet se, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të ëeb-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara duke përmbushur plotësisht këtë standart.</i> | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporte, i cili ofrohet programin Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor ka një plan për mbështetje financiare dhe raport financiar të kostosë së njësisë bazë.</p> <p>Metodologjia e hartimit të raportit financiar të kostove të njësisë bazë analizon të dhënat e kostove të programit të këtij studimit në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personelin akademik me kohë të plotë, - Personelin akademik me kohë të pjesshme; - Shpenzime të stafit të Sekretarisë Mësimore, - Shpenzime te baza materiale didaktike, - Shpenzime të tjera (energji, ujë, etj) dhe amortizim vjetor, <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021- 2022.</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>Plani i financimi të përbashkët të të gjithë strukturës universitare, është institucional I vet Universitetit të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’. Për programet e studimit, është në planifikim e sipër detajimi i planit financiar, të bazuar te njësitë bazë. Në buxhetin e Universitetit të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - grantet nga pushteti qendror, - grantet për mësimdhënien dhe funksionimin, - grantet për kërkim dhe kontratat, - fondet jopublike, - shpenzime për projekte shkencore, - të ardhurat, etj. <p>Të gjitha këto janë të miratuara sipas vendimeve të Senatit dhe Bordit të Administrimit. Institucioni nëpërmjet Zyrës së Administratorit, përcjell për miratim Ministrisë së Financave, Degës së Thesarit, Planin Financiar të vitit përkatës të detajuar.</p> <p>Evidenca 2.3: Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi, nga institucione përkatëse të auditimit (ministra etj). Institucioni nënshtrohet vazhdimisht auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacion për gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar, sic është edhe në raportin e Auditit.</p> <p>Evidenca 4.14: Raporti i Auditit KLSH 2022.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> <p>GVJ konstaton se raportimi i institucionit përmban të dhëna për:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Të dhëna të përgjithshme mbi Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj. b) Planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit. c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik në vijim. d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021- 2022.</p> <p>Evidenca 4.15: Miratimi i regjistrut të prokurimeve dhe shërbimeve.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit</p> | <p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë, Departamentit të Edukimit</p> |

| të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Fizik dhe Sporte, dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, duke u bazuar në Ligjet në fuqi dhe planet për mbështetje financiare për program studimi. Gjatë viteve të fundit buxheti i institucionit ka qenë i mjaftueshëm dhe ka garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen me sukses të programit të studimit. | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Konkluzione | <i>Bazuar në vizitën në institucion dhe në evidencat, GVJ konstaton se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbyshur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. GVJ, konsaton se Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', përmbysh plotësisht këtë standart.</i> | | | | | | |
| Shkalla e përmbyshjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbyshet kryesisht</th> <th>Përmbyshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | | X |
| | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| Shkalla e përmbyshjes së standardevë të fushës IV | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht |
|---|----------------------|-----------------------|
| | | X |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|--|---|
| Standardi V.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Univeristeti i Elbasanit, 'Aleksandër Xhuvani', harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve, në rastin konkret, programet e nivelit të dytë të studimit, specifikisht Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" Fakulteti i Shkencave të Edukimit, në Universitetin e Elbasanit, 'Aleksandër Xhuvani', e zhvillon veprimtarinë e tij, bazuar në 'Rregulloren e Studimeve të Universitetit të Elbasanit', 'Rregulloren e Studimit, Të fakultetit të Shkencave të Edukimit', si dhe në |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: ecce.ascal.al

57

| | |
|---|--|
| | <p>Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor Edukim Shëndetësor'.</p> <p>Bazuar në 'Rregulloren e e Studimit, Të fakultetit të Shkencave të Edukimit', e miratuar në datën 05/04/2020, nr.31, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 datë 22/07/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë', i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit Aleksandër Xhuvani. Në kreun 2, Neni 12 dhe 13 paraqet kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimit të ciklit të dytë si dhe pranimin në programet e ciklit të dytë të studimeve. Kjo rregullore paraqet në kreun 7, nenin 54, regjistrimin e studentëve në programet e studimit.</p> <p>Rregullorja paraqet qartë, kushtet dhe procedurat e transferimit (kreu 6, Neni 50 dhe 51), mbarëvajtjen dhe mësimdhënien (Kreu 4, Neni 28-30), frekuentimin (Neni 31) etj.</p> <p>Një element i rëndësishëm për tu përmendur, është edhe qartësia e rregullores së Programit të Studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor, e cila paraqet kontrollit të dijes dhe njohurive, mbarëvajtjen e sistemit të provimeve dhe vlerësimit, që gjenden në Kreun 5, Vlerësimi i Studentëve (Kreu 5, Neni 19-24).</p> <p>Gjithashtu, Programi i ciklit të dytë, Master Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukim Shëndetësor', zbaton rregulloren e programeve të ciklit të dytë, të miratuar me vendim Senati Akademik, Nr 31 datë 05/04/2020, cila përmban detaje rreth objektivave, qëllimit të studimit, formës së matjes së njohurive, sezonet e provimeve, praktikat profesionale, diplomimin etj.</p> <p>Evidenca 1.2: Rregullore e studimeve UNIEL Kreu 8, Neni, 63, 65. Evidenca 1.7: Rregullore e Studimit e Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Evidenca 1.8: Rregullore e programit të Studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukimi Shëndetësor.</p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në rregulloret e Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani, (të cilat janë realizuar duke u mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe miratuar nga Senati Akademik) si dhe Në rregulloren e Programi të Studimit Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor Edukimi Shëndetësor, paraqet në kreun 8, te drejtave dhe detyrimeve të studentit, që përfshihet satusi i tij, etika dhe sjellja.</p> <p>Politikat e strategjive që gjenden në Plani Strategjik 2020-2024 (pika 1,5), dhe rregulloret e Universitetit dhe programit të ciklit të dytë, paraqesin garantim të barazisë dhe të drejta të barabarta për të gjithë</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>studentët.</p> <p>Evidenca 2.9: Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> <p>Evidenca 1.8: Rregullorja e programit të studimi, Kreu 7 neni 28, 29.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>Fakulteti publikon çdo vit kriteret e miratuar për pranimet në programin Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" në faqen zyrtare të universitetit si dhe afishimet në ambientet e përcaktuara për lajmërimet. Faqja zyrtare online, në rubrikën Studenti, paraqet njoftime të përditësuara me fokus studentët (duke zbatuar kalendarin e paraqitur nga MAS, për ndjekjen e procedurave të regjistrimeve për studentët e rinjë) për regjistrimet, si dhe veprimtarive të ndryshme që realizohen në këtë institucion (https://www.uniel.edu.al/zona-studentit/kontakte). Institucioni bashkëpunon me DAR/ZA, Shkollat e Mesme të Përgjithshme dhe Profesionale Sportive për informimin e maturanëve me programet e studimit që fakulteti i Shkencave të Edukimit ofron. Fakulteti informon maturanët si student të ardhshëm përmes faqes zyrtare të Eëb, njoftimeve në rrjetet sociale, njoftimeve e informacioneve në ambientet e Fakultetit si dhe nëpërmjet publikimit të guidës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> <p>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Nëpërmjet platformës online, si dhe informimet nga zyrat përkatëse, të gjithë maturanët ose aplikuesit e interesuar, informohen për procedurat e pranimit, përzgjedhjes, të transferimit apo dhe të aplikanteve që dëshirojnë të studijojnë si program të dytë studimi për departamentin dhe programin përkatës. mbështetur në aktet ligjore në fuqi dhe në udhëzimet e MASR</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se Në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve në bashkëpunim me Dekanatin e FSHE organizon takim me studentët e rinj për t'i informuar rreth procedurës së vlerësimit të dijeve si dhe për procedurat e diplomimit mbështetur në Rregulloren e UE si dhe i pasqyron ato në faqen e eëb.</p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e programeve të ciklit të dytë, paraqitet qartë transferimet e studimit, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Nga vizita në institucion, konstatohet se rregulloret janë të printuara dhe të afishuara në ambientet fizike të institucionit, ku studentët kanë akses të lehtë siç është sekretaria mësimore dhe zyra e departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve.</p> <p>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje</p> | <p>Platforma online, përmban sesionin e njoftimeve, ku institucioni informon publikun dhe të gjithë të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta (specifikisht kurrikulat dhe shpërndarjen</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|--|
| <p>me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>e ngarkesës së çdo lende, të ndarë në semestra), të çdo program studimi, specifikisht të program Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor.</p> <p>Përpara çdo viti akademik Institucioni harton, miraton dhe publikon kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve në këtë program.</p> <p>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB. Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p> | | |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani, bazohet në kriteret e përgjithshme që janë të përcaktuar nga dispozitat ligjore të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe ndryshe, të pakicave dhe grupeve të marginalizuara. Politikat dhe strategjitë që ky institucion harton dhe zbaton janë sa specifike aq edhe të përgjithshme (bazohen në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit, për grupet e veçanta). Kjo paraqitet te Vendimi i Senatit akademik për kapacitetet për vitin akademik 2022-2023, për kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Evidenca 5.1: Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p> | | |
| <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit Aleksander Xhuvani, bazohet në kriteret e përgjithshme që janë të përcaktuar nga aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve nga trevat dhe shtetet e ndryshme.</p> <p>Evidenca 5.1: Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p> | | |
| <p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit Aleksander Xhuvani, në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.</p> <p>Niveli i lartë i rezultateve të tyre, si nga mesatarja e shkollave të mesme, qoftë nga rezultatet e larta të përfituara në vitin e parë akademik, u mundëson të gëzojnë të drejtën e bursave. Hartimin e politikave të bursave, insitucioni e ka në përputhshmëri me ligjin e arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca 5.2: Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet.</p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Ëeb site: eëe.asc.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>Rregullore e Studimeve të Universitetit të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, si dhe Rregullore e Programit të studimit ‘Master Profesional në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil Minor në Edukim Shëndetësor’, disponojnë informacion të qartë dhe të plotë për studentët rreth procedurave të përparimit të vitit akademik dhe detyrimet për të kaluar në një tjetër vit akademik.</p> <p>Gjithashtu, faqja zyrtare e Universitetit Elbasanit Aleksandër Xhuvani’, ofron informacionin e duhur për studentët për kriteret, procedurat dhe datat (kalendarin akademik të vitit përkatës), orarin, e fillimit të studimeve në programin e Master Professional, ‘Mësuesi në Edukim në Edukim dhe Sporte me profil Minor në Edukim Shëndetësor’. Studentët informohen edhe me postë elektorinike në adresat elektronike të tyre. nëpërmjet sistemit EMS për vlerësimin e tyre nga stafi akademik dhe ofron mundësi të komunikimit të drejtpërdrejtë të tyre</p> <p>Institucioni disponon edhe informacionin në ambientet e përcaktuara, të njoftimeve për secilin fakultet.</p> <p><i>Evidenca 1.2: Rregullore e Studimeve UNIEL, Kreu I Neni, 1, 3, 6. Kreu IV Neni 31, 33, 34, 36. Kreu VI, Neni. 50, 51, 52, 53.</i></p> <p><i>Evidenca 1.8: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> | <p>Në rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Universitetit të Elbasanit Aleksandër Xhuvani, paraqitet qartë informimi për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p><i>Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Universiteti I Elbasanit Aleksandër Xhuvani, nëpërmjet rregullores, lajmërimeve në vendin e përcaktuar në ambientet e çdo fakulteti përkatës, në syllabuset e lëndëve të prezantuar në auditor, dhe nëpërmjet lançimit të syllabuseve dhe mënyrës së vlerësimit në faqen zyrtare online, i informon studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive që do të përvetësohen në lëndët që ata do të frekuentojnë.</p> <p>Lektori përgjegjës i lëndës/ modulit në orën e parë të Seminarit Orientues njeh studentët me kriteret e lëndës dhe vlerësimin e tyre. Institucioni e paraqet informacionin nëpërmjet disa lloje kanalesh komunikimi, si të afishuar, online dhe nëpërmjet stafit akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL Kreu 5, Neni, 40,41,42</i></p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p><i>Evidenca 2.17. Modeli i syllabuseve</i> <i>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</i></p> <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, në rregulloren e ciklit të dytë të programeve të studimit, specifikisht në Kreun 8, Neni 62, për diplomimin, përcakton qartë modalitetet e diplomimit, zgjedhjen dhe ndryshim e udhëheqësit, ndryshimin e temës së diplomës, përgatitjen dhe organizimin e mbrojtjes së diplomës (në dy forma, teorike të paraqitur me format të printuar (mikro teza) dhe me provim), si dhe vlerësimin e saj. Kjo rregullore ndodhet e printuar edhe në ambientet e departamentit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konston se, zhvillohet një komunikim vazhdueshëm dydimensional, midis studentëve, përgjegjësit të Elbasanit, si dhe stafit akademik. Departamenti përgjegjës informon studentët lidhur me kriteret e procedurat e punimit të diplomës/provimit përfundimtar të formimit për diplomimin në programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" duke publikuar në faqen zyrtare të Web-it datën e fillimit e mbarimit të procesit dhe materialin e nevojshëm për përgatitjen e detyrimeve përmblylëse të programit të studimit bëhet nëpërmjet Pedagogut mentor. Gjithashtu, studentët njihen me Manualin e Punimit të Diplomës, nga shefi i të miratuar nga institucioni, departamentit, faqja zyrtare online, dhe pedagogu mentor.</p> <p><i>Evidenca 1.2: Rregullore e Studimeve UNIEL Kreu 8 Neni, 62, 65.</i> <i>Evidenca 3.5: Manuali i punimit të diplomës.</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani, organizon takime në ‘Ditët e hapura’ për informimin e maturantëve për programin e studimit. Fakulteti informon studentët e ardhshëm nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare të Eëb, në rrjetet sociale, njoftimet e informacionet e vendosura në stendat e Fakultetit si dhe publikimin e guidës të Universiteti të Elbasanit Aleksandër Xhuvani si dhe Fakultetin e Shkencave të Edukimit.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, nëpërmjet Fakultetit të Shkencave të Edukimit, realizon komunikime të vazhdueshme me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrrat Arsimore, Shkollat e Mesme të Përgjithshme dhe Profesionale Sportive, me qëllim të rris interesin e maturantëve për të vazhduar studimet në programet që ofron Fakulteti i Shkencave të Edukimit, specifikisht departamenti.</p> <p>GVJ konstaton se stafi akademik i Fakultetit të Shkencave të Edukimit, merr pjesë në ditët e hapura dhe paniret e organizuara nga MASR me qëllimin për nformimin publik në bashkëpunim me MASR bëhet kur maturantët janë në periudhën e zgjedhjes së programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5.3: Kalendari i ditëve të hapura 2022.</i></p> |

| | | | |
|--|---|----------------------|-----------------------|
| | <i>Evidenca 5.4: Publikimi i spotit promovues.</i> <i>Evidenca 5.5: Fletëpalosjet promovuese institucionale.</i> | | |
| Konkluzione | GVJ vlerëson se Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', vë në dispozicion të plotë të studentëve të programit të studimit Master Profesional Mësues në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor', si dhe mundëson qarkullimin e informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit e tyre. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.3 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', në fillim të vitit akademik, gjatë javë së parë, informon studentët për strukturën, planin mësimor, lëndët, provimeve për çdo semestër si dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Njoftimi realizohet nëpërmjet organizimit të takimeve informuese, afishimit të informacioneve të programit në stendat e fakultetit, në faqen zyrtare të Eëb-it, nëpërmjet publikimit edhe në rrjetet sociale.</p> <p>Gjithashtu, rregullore e ciklit të dytë të studimeve, specifikisht Master Profesional Mësuesi në Edukimi Fizik me Profil Minor në Edukim Shëndetësor, jep informacione të detajuara për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të nivelit të dytë të studimit.</p> <p>Ky informacion disponohet edhe nga zyra e studentit, si dhe nëpërmjet këshillimit me stafin akademik, përpara regjistrimit të studentit. Informacioni mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të universiteti.</p> <p><i>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</i> <i>Evidenca 1.8: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</i></p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | <p>Në faqen zyrtare online të universitetit, paraqitet programi i studimit me lëndët që ka çdo program. Lëndët janë të përcaktuar në secilin semestër, me ngarkesën përkatëse dhe kategorizimin e tyre. Studenti i akseson të dhënat edhe nëpërmjet llogarisë të dedikuar të EMS.</p> <p>Ndërsa, syllabuset e lëndëve, që prezantohen nga stafik akademik që zhvillohen lëndët, japin informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuara lëndët dhe modulet mësimore, dhe</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>veprimtaritë formuese të tyre. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve etj.</p> <p>Evidenca 4.12: Rregullorja EMS. Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Ngritja e Bordit Këshillimor të Biznesit, i cili përfshinë në aktivitete të shumta informuese për ti njohur ata me kërkesat e punëdhënësve. Gjatë vizitës institucionale së GVJ-së në Universitetin e Elbasanit 'Aleksadër Xhuvani', si dhe takimin me studentët, ata shprehen pozitivisht dhe ndiheshin të mbështetur dhe të motivuar prej stafit akademik, të cilët u kishin mundësuar lidhjet me institucionet ku një pjesë e tyre aktualisht ishin të punësuar (specifikisht në orkestrën e ushtrisë).</p> <p>Tregues ky, që mundëson institucioni u jep mbështetje dhe orientim studentëve për tregun e punës</p> <p>Evidenca 5.6: Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit. Evidenca 4.6 'Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022.</p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Rregullore e Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" paraqet një kre të veçantë, për informimin e studentëve, që nëpërmjet këshillit të studentëve, vendosin në dispozicion urën e informimit të vazhdueshëm.</p> <p>Departamenti mundëson zhvillimin e procesit mësimor në kushte të mira, për studentët, duke marr në konsideratë karakteristikat e programit të studimit. Studentët kanë në dispozicion të gjithë logjistikën e nevojshme, labororet si dhe ambjentet sportive për realizimin sa më optimal të programit të studimit.</p> <p>Nga vizita e GVJ-së në institucion, konstatohet se stafi akademik duke kaluar shumë kohë në ambientet e institucionit, për punën akademike dhe për aktivitete sportive dhe pedagogjike me studentët, kanë një komunikim të vazhdueshëm dhe të harmonizuar.</p> <p>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB Evidenca 1.8: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</p> |
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> | <p>Lehtësia në arritjen e komunikimit realizohet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faqes zyrtare online të universitetit 2. Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë. 3. Pikët individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim në praktikimin sportiv. 4. Mundësi komunikimi online dhe offline mes studentëve dhe |

| | <p>pedagogëve.</p> <p>5. Mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit EMS.</p> <p>Nga vizita institucionale e GVJ-së, konstatohet se studentët kanë komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik si dhe nëpërmjet sistemi të menaxhimit për qarkullimin e informacionit të brendshëm.</p> <p>Evidenca 4.12: Rregullorja EMS</p> <p>Evidenca 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</p> | | | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Konkluzione | <p>GVJ vlerëson se, Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', përmbush plotësisht standartin V.3, sepse në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit, të cilat janë plotësisht të aksesueshme edhe në faqen zyrtare online.</p> | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përmbushet | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| | |
|---|---|
| Standardi V.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin i Elbasanit, 'Aleksandër Xhuvani', konstatohet se zyra e sekretarisë mësimore disponon të gjitha të dhënat e arritjeve akademike të studentëve, me regjistrat përkatës dhe dokumentacionin e arkivuar. Kjo zyrë disponon statistika të çdo viti akademik, por edhe të pesë viteve të fundit të programit të Master Profesional 'Mësuesi në Edukim Fizik me profil minor NË Edukim Shëndetësor'. Sekretaria Mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve EMS si dhe regjistrave ruan të gjitha të dhënat statistikore.</p> <p>Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.</p> <p>Evidenca 5.7: Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-202.</p> <p>Evidenca 4.12: Rregullorja EMS.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet</p> | <p>Universiteti I Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', disponon të dhëna dhe përpilime statistikore për studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional ' Mësuesi në Edukim Fizik me profil Minor në Edukim Shëndetësor'. Këto të dhëna i disponon sekretaria mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve EMS si dhe regjistrave. Paketa softëare EMS mundëson një databazë të dhënash mbi studentët për këtë cikël studimi.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në zyrën e sekretarisë mësimore, në</p> |

| | | | | | |
|--|--|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| programi i studimeve. | <p>Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', konstatohet se informacioni rreth statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga program, largimet para diplomimit, ngrirjet e studimeve dhe përfundimi me sukses ose jo i programit të studimit, ishin të detajuara, regjistruara dhe arkivuara.</p> <p>Evidenca 1.2: Rregullore e Studimit UNIEL, Neni 71,72,73. Apendix Tabela 21, 21.1.</p> | | | | |
| <p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse. Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u prezantua me zyrën mësimore, e cila disponoji të dhënat zyrtare statistikore të pesë viteve të fundit të programit Master Profesional 'Mësuesi në Edukim Fizik më profil Minor në Edukim Shëndetësor'.</p> <p>Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL Neni 14, 22.</p> | | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', disponon të dhëna dhe përpilime statistikore për studentët e regjistruar në programim e studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor".</p> <p>Të dhëna i disponon sekretaria mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve EMS si dhe regjistrave. Paketa software EMS mundëson një database të dhënash mbi studentët për ciklin e studimit. Institucioni nëpërmjet zyrave përkatëse, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit UNIEL, Neni 9, pika12.</p> | | | | |
| <p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Në fund të vitit akademik Departamenti i edukimit Fizik dhe Sporteve, përgjegjës për Masterin Profesional "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor" harton dhe raporton të dhëna analitike periodike mbi ecurinë dhe veprimtarinë mësimore të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me strategjitë e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p>Evidenca 1.15 Analizë Vjetore e Departamentit.</p> | | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ vlerëson se, Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', përbush plotësisht standartin V.4, për arsye se ruan të dhëna të hollësishme (i mbledh, administron dhe përditëson), në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p> | | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <tr> <td>Përbushet plotësisht</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table> | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ nxit dhe përfshin në diskutime dhe organizime, studentët dhe strukturat e tyre. Studentët përfaqësohen në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit siç janë: Senati, Këshillin Studentor si dhe grupe pune nëpërmjet kontributi që japin (sipas rregullores së organizimit dhe funksionimit). Në Senatit Akademik të universiteti, ka përfaqësues edhe studentë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, specifikisht nga departamenti i Eukimit Fizik dhe Sporteve.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL.</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ garanton përfshirjen e studentëve dhe përfaqësinë e tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik nëpërmjet përfaqësive të tyre në Studentët kanë të drejtë të jenë të përfaqësuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Senatin Akdemik; 2-Këshillin e etikës; 3-Komisionet e përherëshme të lejuara më statut; 4-Këshillat e studentëve. <p>Institucioni garanton përfshirjen dhe marrjen në konsideratë të mendimeve dhe propozimeve të studentëve. Kjo konstatohet edhe në takimin me studentëve gjatë vizitës së GVJ-së, ku studentët ishin të angazhuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre, kanë përfaqësuesin e tyre në Komisionin Institucional Zgjedhor si dhe janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 2.1: Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL.</i> <i>Evidenca 2.2: Rregullore e Këshillit Studentor.</i> <i>Evidenca 5.8: Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor.</i> <i>Evidenca 5.9: Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional.</i> <i>Evidenca 5.10: Urdhri për komisionet e përherëshme Institucionale në UNIEL.</i> <i>Evidenca 5.11: Urdhri për komisionet e përherëshme në Fakultet),</i> <i>Evidenca 5.12: Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në</p> | <p>Njësitë bazë, departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve kanë komunikim dhe takime të vazhdueshme me studentët, për shkak të</p> |

| | |
|---|---|
| <p>procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>specifikës që zotëron. Në takimin e zhvilluar me studentët me GVJ-së, konstatohet se studentët ndihen të lirë dhe të hapur për të shprehur mendimin dhe dhënë kontributin e tyre në takimet, mbledhjet dhe aktivitetet artistike. Studentët janë pjesëmarrës edhe në mbledhjet e hapura në departament, në programet dhe aktivitete e ndryshme artistike që organizohen gjatë semestrit.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së konstatohet se në ndryshimet e bëra në programi i studimit Master Profesional i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit, i cili u riorganizua në zbatim të akteve ligjore në fuqi, u është bërë i njohur studentëve në takimet e organizuara me ta. Sugjerimet e tyre janë reflektuar në programin e ri. Për riorganizimin e Masterit Profesional në Senatit Akademik kanë marrë pjesë dhe dy studentet.</p> <p><i>Evidenca 1.7: Rregullore e studimit e FSHE Kreu I, Neni 3.</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Në rregulloren e studimeve të Universiteti të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, cikli i dytë, paraqitet kontrolli i dijes, ku njihen të drejta të barabarta, pa asnjë ndarje, midis studentëve të këtij programi. Rregulloret e brendshme përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Procesi i zhvillimit të sezonit të provimit, promovimi dhe kontrolli i dijeve, dokumenti i vlerësimit të studentit si dhe e drejta e përmirësimit të notave janë pjesë e rëndësishme në rregulloren e ciklit të dytë të studimit.</p> <p>Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. Në rast se studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin ai ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda ditës së shpalljes së rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura. Nëse verifikohet gabim i korigjueshëm nga përgjegjësi i departamentit, në bashkeveprim me komisionin e provimit realizohet korigjimi. Kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vihet në dijeni Dekanin, i cili nga pasja e dijenisë për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose mund të marrë vendim për rrizhvim të provimit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve në UNIEL, Kreu 5, Neni 40, 42, 46.</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të Studimit “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” Kreu 8, Neni 32, Pika c dhe g.</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ vlerëson se, Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, përmbush plotësisht standartin V.5, për arsye se përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre..</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi V.6 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, konstatohet se ky institucion në shërbim të informimit të studentëve, por edhe përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore të tij, gjendet zyra e Informimit të Studentëve, të Këshillimit dhe të Karrierës, dhe Alumni, e cila kategorizohet si njësi ndihmëse në funksion të institucionit.</p> <p>Institucioni posedon njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve. Këto struktura janë institucionale si Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët vënë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë.</p> <p><i>Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>Evidenca 5.13: Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL.</i></p> |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit Me anë të komunikimit direkt (EMS) me studentin, stafi akademik informon dhe informohet për procesin mësimor, mungesat apo vlerësimin teorik apo praktik të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5.13: Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL.</i></p> |
| Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin | <p>Në bashkëpunim me këshilluesit e karrierës së çdo njësie bazë dhe kryesore, në bashkëpunim me zyrën e informimit të studentëve, të këshillimit dhe karrierës, dhe Alumni, zhvillojnë takime dhe aktivitete për çështje të ndryshme në këtë fushë.</p> <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve siç janë Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë,</p> |

| për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion dhe takimit me studentët, konstatohet se të gjithë studentët ishin të informuar, të familjarizuar dhe orientuar për çështje të ndryshme nga kjo zyrë. Gjithashtu, studentët ishin të orientuar të zhvillonin praktikat mësimore ose intervista pune, me orientimin e kësaj zyre dhe stafit akademik të njësisë bazë, në institucionet ku Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', ka marrëveshje ose me zgjedhjet e tyre preferenciale. Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL. | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', zotëron njësinë e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. Evidenca 5.7: Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022 | | | | | | |
| Konkluzione | GVJ vlerëson se, Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', përmbush plotësisht standartin V.6, për arsye se zotëron procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|---|---|
| Standardi VI.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, | UNIEL ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë. Konstatohet se gjatë vizitës në GVJ-së, në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', mësimdhënia shoqërohet edhe me strukturimin e |

| | |
|---|--|
| lëndëve/moduleve. | <p>ambienteve sipas kriterëve të programit dhe departamentit, në ambientet fizike. Përdorimi metodave të ndryshme bashkëkohore sipas moduleve të lëndëve specifike të programit (siç janë lëndët e sporteve), bashkojnë përvojën shumëvjeçare të institucionit me metodikat moderne të përfituara gjatë kualifikimit të stafit ndër vite.</p> <p>Evidenca 6.1: Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Njësia bazë, e cila së bashku me njësinë kryesore dhe në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, zhvillojnë monitorime dhe vlerësojnë aftësitë e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik, nëpërmjet formularit të performancës. Duke mos cënuar lirinë akademike, monitorimi i stafit në ambientet fizike ku zhvillohen orët mësimore (duke marrë parasysh specifikat e lëndës), me kërkesën për përmirësim nga studentët, mund të vlerësohet nga një grup i ngritur nga njësia bazë.</p> <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, nëpërmjet Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në Institutin dhe Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultet.</p> <p>Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.</p> <p>Evidenca 5.11: Urdhëri për Komisionet e përhershme në Fakultet. Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 5.10: Urdhëri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL. Evidenca 5.11: Urdhëri për Komisionet e përhershme në Fakultet.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka ngritur Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në UNIEL dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet. Nga të dhënat e këtij formulari, njësia bazë dhe kryesore vihet në dijeni dhe merren masa për vazhdimësinë procedurale.</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, zhvilluar në Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporte, gjatë takimit me studentët, kostatohet së studentët, jo vetëm nëpërmjet formati të vlerësimit periodik të stafit akademik, por edhe për çdo pakënaqësi që mund të kenë, ndihen të lirshëm ta diskutojnë me profesorin e lëndës dhe me drejtuesin e njësinë bazë.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 5.10: Urdhëri për Komisionet e përhershme Institucionale</p> |

| | | | | |
|--|--|-----------------------------|-------------------|------------------------------|
| | <i>në UNIEL.</i> | | | |
| | Evidenca 5.11: Urdhëri për Komisionet e përhershme në Fakultet. | | | |
| Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani' ka funksional Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës. Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', nëpërmjet vlerësimit dhe rezultateve të marra nëpërmjet anketimeve, pyetsorëve të organizuar si nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe nga njësia bazë, promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies Gjithashtu, praktikat e shkëmbimeve të stafit akademik, të ofruara nga projekte dhe marrëveshje të ndryshme, u jep mundësi atyre në përfitimin e përvojave të reja dhe të ndryshme, si dhe reflektimin e tyre gjatë mësimdhënies në këtë institucion. Evidenca 6.2; Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 1.15; Analiza vjetore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve. | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.1 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', ndjek politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Sigurimi i cilësisë mbetet kërkesë themelore e Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', për rritjen e reputacionit brenda dhe jashtë vendit, duke u bazuar në aktet dhe nënaktet ligjore të arsimit të lartë "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë". Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performances. Të dhënat publikohen me qëllim transparence të rezultatetve dhe rekomandimeve. Pyetësorët realizohen dy herë në vit, para fillimit të çdo sezoni të provimeve. Kjo procedurë realizohet nëpërmjet urdhërave të posaçëm |

| | |
|--|---|
| | <p>që paraqiten si në evidencën e poshtëshënuar.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 6.3: Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Institucioni angazhon edhe personelin akademik të ftuar, të angazhuar në mësimdhënie, personalitete nga Brenda dhe jashtë vendit, për rritjen e cilësisë.</p> <p>Sipas Planit strategjik 2020-2024, zbatimi i strategjive së rritjes së cilësisë së brendëshme, është e vazhdueshme për tu përgjigjur kërkesave të aktualitetit.</p> <p>Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar nga vetë Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet); • Zyra e NJSBC • Njësia kryesore dhe bazë • etj <p>Konstatohet se gjatë vizitës së GVJ-së, në institucion, plani zbatohet në dukje me diversitet modelesh, metodash etj, gjatë procesit të mësimdhënies, në formulimin e kurrikulave si dhe në aktivitetet e ndryshme me profil sportiv. Për këtë promovohet mësimi e krijimtaria përmes angazhimit në punë praktike konkrete (praktika mësimore) qëllim arrijten e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.</p> <p>Evidenca 1.3: Strategjia e UNIEL. Evidenca 6.4: Lista e Personelit të Ftuar të angazhuar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, mundëson realizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë në bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL. Ky institucion i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë. Në vlerësimin e fundit, është akredituar institucionalisht për një afat 6 vjeçar sipas vendimit të Bordit të Akreditimit të ASCAL : Vendim BA Nr. 49, datë 27.11.2022 Për Akreditimin e UNIEL.”</p> <p>Evidenca 1.6: Certifikata e Akreditimit Institucional.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,</p> | <p>NJSBC në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ ka në fokus ndërgjyegjësimin e personelit akademik, ndihmësmësimor dhe të studentëve që ndjekin programet e studimit të ofruara, për rëndësinë e cilësisë se programeve të studimit si dhe për sigurimin e cilësisë së tyre. NJSBC harton raporte në mënyrë periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, të cilat</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| <p>institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>përdoren si burim për vlerësimet e brendëshme dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet përfshihen në analizen vjetore të Senatit Akademik.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022.</p> <p>Evidenca 2.9: Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.2 përmbushet plotësisht, sepse Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të cilësisë. GVJ vlerëson se standarti përmbushet kryesisht, për shkak se NJSBC duhet të jetë prezente dhe aktive në dhënien e udhëzimeve dhe ndihmës për njësinë bazë.</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', nëpërmjet planit strategjik të 2020-2024, paraqet strategji dhe politika për përmirësimin e procesit akademik të programeve të studimit.</p> <p>Edukimi në këtë institucion përmbush këto detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e programeve të studimit; • Forcimin e orientimit drejt studentëve dhe tregut; • Zgjerimin e edukimit drejt specializimeve të gjera dhe zhvillimi i formave të reja të edukimit; • Sigurimin e infrastrukturës së mësimit dhe asaj organizative; • Forcimin e kompetencave akademike, profesionale, sociale dhe etike të edukimit. <p>NJSBC e Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', ka hartuar dhe vënë në përdorim mekanizma e instrumenta për mbikëqyrjen e ecurisë të programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional". Përkatësisht ky pyetësor synon të vjelë informacion nga student, lidhur me nivelin e përmbajtjes së lëndëve, elementet praktik dhe profesional si dhe ndërdisiplinore që ofron programi i studimit që ndjekin, cilësinë e mësimdhënies dhe didaktika/metodologjia e saj, larmishmërinë e llojeve të materialeve për mësimdhënie, angazhimin e stafit akademik dhe gatishmërinë e tyre në ndihmë të studentëve, lidhjen midis studentëve dhe stafit; mjediset dhe infrastruktura që ofrohet nga institucioni.</p> <p>Nisur nga vizita e GVJ-së në këtë institucion, konstatohet se programi i studimit të ciklit të dytë, janë të mirëorganizuara, sipas akteve ligjore,</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>me lëndët specifike modern të profesionit, orientimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional, si dhe në përfshirjen e studentëve në programe dhe veprimtaritë sportive.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 1.15: Analiza vjetore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve.</p> |
| <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, Zyra e këshillimit të studentëve, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë, nëpërmjet komisionit të ngritur në fakultet, zhvillojnë takime dhe diskutime të shpeshta me studentët, për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, analizat vjetore të njësive bazë dhe raportet periodike të NJSBC përfshijnë rezultatet e marra dhe shprehin dhe disa rekomandime për të përmbushur kërkesat e studentëve, lidhur me aspektet e procesit të mësimdhënies dhe nxënies.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 1.15: Analiza vjetore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>Si garantues i cilësisë është kryesore njësia bazë, me përgjegjësin e departamentit për vlerësimin e secilit pedagog të lëndëve. Në “formular për vlerësimin e pedagogut nga eprori-kolegu” jepen disa kriteret që vlerësohen sipas renditjes nga shumë mirë, mirë, pjesërisht dhe dobët. Nëpërmjet këtij formulari, vlerësohet organizimi dhe qartësia, si edhe komunikimi me studentët.</p> <p>Ndërsa nëpërmjet formularit që studentët vlerësojnë pedagogun, përpara sezonit të provimeve (për të mos pasur konflikt interesi), maten elementët e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimet objektive të profesorit ndaj studentit, komunikimi, entuziazmi, mënyra e përdorimit të referencave bashkëkohore dhe të dobishme për studentët, zotërimin e njohurive dhe përdorimin e tyre me efikasitet në auditor etj.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita e GVJ-së në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, konstatohet se, praktikat akademike të përdorura për përgatitjen e studentëve, mundëson aftësinë e studentëve për të qenë specialist të edukimit të sporteve dhe tës hendëtit fizik në tregun e punës në Shqipëri. Institucioni, në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda bashkëkohore. Vlerësimi i të nxënies, vlerësimet në provime dhe kryerjes së praktikave paraqiten në analizën vjetore të departamentit. Vlerësimet identifikojnë kryesisht kalueshmërinë dhe notën mesatare të paraqesin edhe efikasitetin e mësimdhënies e nxënies, në çdo lëndë të programin e studimit, Master Profesional Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporteve me profil minor në edukim Shëndësor .</p> |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| | Evidenca 1.15: Analiza vjetore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve. | | |
| Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | <p>Universiteti i Elbsanit 'Aleksandër Xhuvani', vlerëson veprimtarinë akademike për cilësinë e saj, nëpërmjet pyetësorëve me studentët për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Marrja e vlerësimeve nga studentët realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësotrëve me studentët e programit të studimit; • Pyetësorëve rreth vlerësimit të didaktikës dhe kurikulës; • Si dhe intervista në formë bisedash midis stafit përgjegjës (në pjesën më të madhe shefit të departamentit). <p>Gjithashtu, Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore përdor në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit metoda të tërthorta: sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve, sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista etj.</p> <p>Të dhënat mblidhen dhe përpunohen nga zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, dhe paraqiten në njësinë bazë, e cila e përcjellë në njësinë kryesore.</p> <p>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 5.7 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022.</p> | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.3 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Elbsanit 'Aleksandër Xhuvani', monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëni.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësité akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të | Universiteti i Elbsanit 'Aleksandër Xhuvani', nëpërmjet Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ofron mundësinë për garantimin e cilësisë së tij dhe programeve të studimit. Ky njësi përbëhet nga komisione me anëtarë në secilin fakultet si dhe një përfaqësues nga studentët. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, parashikon garantimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë nëpërmjet krijimit të njësive për sigurimin e brendshëm të cilësisë për çdo program studimi që |



| | |
|--|---|
| studimit. | <p>ajo ofron. Kjo realizohet duke ngritur grupet e punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë si në rastin aktual në kuadër të procesit të akreditimit të programeve. Grupet e jashtme të vlerësimit gjatë këtij procesi bejnë të mundur si mbikqyrjen dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit në veçanti, ashtu dhe atij institucional në tërësi. Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion, konstatohet se komisioni dhe grupet e punës, kanë funksionuar për të mundur vazhdimësinë e cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.</p> <p>Evidenca 5.10: Urdhëri për Komisionet e Përherëshme Institucionale në UNIEL.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, përcakton organizimin dhe funksionimin, si dhe detyrat konkrete dhe përgjegjësitë e anëtarët e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në Statut dhe në Rregullore.</p> <p>Institucioni ka të përcaktuar në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të saj (neni 18), detyrat konkrete për njësinë.</p> <p>Dekanati me anë të vendimeve të posaçme përcakton detyrat për njësitë e sigurimit të cilësisë së brendshme, anëtarët përberës së këtyre grupeve si personel akademik, ndihmës dhe studentë. Departamenti përkatës koordinon dhe mbikqyr punën e grupit të punës.</p> <p>Ndërkohë në garantimin e sigurimit të cilësisë së brendshme, dhe cilësisë e mbarëvajtjes së programeve të studimit në ciklin e parë dhe të dytë, specifikisht në Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik me profil minor në Edukim Shëndetësor, një rol shumë të rëndësishëm luajnë njësia bazë, njësia kryesore sdi edhe njësi të tjera (siç janë kordinatori i programit, sekretaria mësimore etj).</p> <p>Evidenca 1.4: Rregullore e organizimit dhe Funksionimit UNIEL. Evidenca 5.12: Urdhër për Grupin e Punës për Raportin e Vetëvlerësimit për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor” Evidenca 1.1: Statuti UNIEL</p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> | <p>Në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, Dekanatit I Fakultetit të Shkencave të Edukimit, nëpërmjet vendimet, parashikohet dhe garantohet përfshirja e të gjitha njësive bazë dhe atyre kryesore si dhe përcaktohen anëtarët, përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në keto grupe.</p> <p>Gjithashtu, departamenti i propozon dekanit kordinatorin dhe grupin e punës për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit në rastin specific, Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”</p> <p>Nga vizita në institucion e GVJ-së konstatohet se në këto grupe pune ishin përfshirë anëtarët e departamentit dhe një student.</p> <p>Evidenca 5.12: Urdhër për Grupin e Punës për Raportin e Vetëvlerësimit për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>në Edukim Fizik dhe Sporte, me profil minor në Edukim Shëndetësor”.</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Vendim Dekanati Nr.22, dt.28.09.2022, Nr 354/4prot, Për ‘Ngritjen E Grupit Të Punës Për Hartimin E Raportit Të Për Programet E Studimit Të Cilat Janë Në Proçes Akreditimi Në Fakultetin E Shkencave Të Edukimit’.</i></p> | | |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka procedura të vlerësimit të brendshëm i cili i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar. Përcaktimi i grupeve të punës së vlerësimit të brendshëm bëhet në përputhje me të drejtën e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së të gjitha palëve të interesuara, të personelit akademik me njohuritë dhe ekspertizën e duhur në fushën specifike të programit të studimit dhe një përfaqësues student të atij programi studimi gjë që garanton dhe kryerjen objektive të vlerësimit. Studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit. Studentët mbështeten, dëgjohen kërkesat apo sugjerimet e tyre për t'u përfaqësuar në proceset e vlerësimit.</p> <p>Ky proces parandalon diskriminimet ose pabarazitë, si dhe mundëson integritet të gjithë pjesëtarëve të tjerë që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e këtij grupi.</p> <p><i>Evidenca 6.5: Kodi i Etikës UNIEL.</i></p> | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, ka si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë profil studimi me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë dhe sugjerime, në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, ka marrëveshje me institucione të tjera të ngjashme dhe fton bashkëpunëtorë dhe pedagogë nga këto institucione si psh. Universiteti Sporteve i Tiranës dhe Universiteti Marin Barleti. Pedagogët e ftuar nga këto universitete japin kontributin e tyre për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përshtatjen dhe zhvillimin e programeve lëndore si dhe ofrojnë ekspertizën e tyre për ruajtjen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së programit përkatës të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5.10: Urdhëri për Komisionet e Përherëshme Institucionale në UNIEL.</i></p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.4 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra.</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X |

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Baza rregullatore që ka hartuar Universiteti i Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshin ndër të tjera edhe këto dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; ▪ Statuti; ▪ Rregullorja e institucionit. <p>Një pjesë e dokumentacioni është publike siç janë statuti, rregulloret dhe veprimtaritë, ku të gjithë studentët mund ta marrin nga departamenti, zyra e studenteti, të afihuar etj).</p> <p>Në këtë institucion gjendet dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim transparencën dhe arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Të dhënat e realizuara si rezultat i pyetësorëve institucionalë publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet Informacioni nga monitorimi i njësisve të ndryshme, shkon te rektorati, veçanërisht te zëvendës rektori për çështjet mësimore, dekanët dhe shefat e departamenteve (duhet të rikujtohet se në këtë institucion egziston edhe komunikim i shpejt joformal, për zgjidhjen sa më shpejt të problemeve). Gjatë hartimit të raportit respektohet liria dhe etika akademike, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjatë vizitës të GVJ-së, në dosjet e personelit akademik, gjendeshin dokumentacione të plota të detajuara, përfshirë edhe vlerësimi më i fundit i stafit i përfshirë në dosje.</p> <p><i>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022.</i> <i>Evidenca 6. 5: Kodi i Etikës UNIEL.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ konstatohet se rezultatet nga anketimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta. Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe për të bërë krahasime në periudha kohore si dhe për të bërë vlerësim të performacës. Plani i punës dhe raportet mujore e semestrale të NJSBC po ashtu japin rekomandime të cilat i paraqiten Rektoratit të Universitetit të Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’ i cili më pas ndërmer hapa për të trajtuar dhe zgjidhur problematikat</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe</p> | <p>Nga vizita e GVJ-së në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’,</p> |



| | |
|---|--|
| <p>siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>konstatohet se sigurimi i cilësisë bazohet në disa rrahë të kontrollit dhe disa nivele të zhvillimit siç janë kontrolli nga drejtuesit e departamentit kordinatori i programit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Zyra e Kurrikulave.</p> <p>Për përmirësimin dhe zhvillimin e njësisë bazë, instiucioni monitoron dhe mbështet financiarisht dhe me infrastrukturën e nevojshme grupet e vlerësimit të brendshëm dhe kërkesat që ata parashetrojnë për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022.</p> |
|---|--|

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Universiteti i Elbasanit, nëpërmjet bashkëpunimit me projektet e ndryshme te Erasmus +, etj, u jep mundësinë stafit akademik, administrative dhe studentëve të ndjekin trajnime, workshop, leksione të hapura etj. të cilësisë me standarte ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion vihet re se njësia bazë, mundëson orientime për përmirësimin e sigurisë, specifikisht për programin e studimit të nivelit të dytë. Institucioni zhvillon takime periodike informuese dhe me diskutime të hapura për studentët sipas cikleve të studimit ku informohen për veprimtarite në funksion të përmirësimit të cilësisë, për kërkesat lidhur me infrastrukturën dhe transparencën financiare, takimet për zhvillimin e praktikave profesionale dhe të kurseve të turizmit, skive dhe të notit; takimet me fokus grupet për diskutim dhe informim mbi proceset e vlerësimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit që ata ndjekin.</p> <p>Gjithashtu, analizat vjetore të departamenteve dhe fakultetit paraqesin informacionin përkatës si dhe planin e masave për sigurimin e përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Evidenca 6.2: Publikimi i Raportit 2021-2022</p> |
|---|--|

| | |
|---------------------------|---|
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri V.5 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', nëpërmjet politikave, proceseve dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master i Profesional 'Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Fizik' janë publike, transparente e efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p> |
|---------------------------|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|--|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.

Pikat e forta dhe afirmime



1. Fakulteti i Edukimit, specifikisht Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, nëpërmjet stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve, jep kontributin e tij në fushën e edukimit dhe sporte.
2. Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte me Profil Minor në Edukim Shëndetësor" është i një cilësie të lartë. Programi garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara.
3. Programi është ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës dhe ka të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase. Plani mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.
4. Programi i studimit impletohet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të cilët disponojnë grada, tituj dhe eksperiencë domethënëse akademiko-shkencore. Ky tregues garanton një cilësi të lartë të mësimdhënies.
5. Ambjentet fizike, terrenet sportive dhe ato laboratorike të Universitetit të Elbasanit, specifikisht të Fakultetit të Edukimit janë bashkëkohore, të rikonstruara dhe të përshatshme për realizimin e misionit të tij.
6. Universiteti dhe njësia kryesore kanë një bashkëpunim të institucionalizuar me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi UniEl realizon me sukses objektivat për kërkimin shkencor, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e garantuar të të diplomuarve në këtë program studimi.

Pika të dobëta

1. Fakulteti i Edukimit ka Bibliotekë jo shumë të pasur ndaj ka nevojë për blerje titujsh të rinj bashkëkohorë, por biblioteka është e pajisur me kompjutera për bibliotekën online (Standardi IV.2).
2. Duhet të ketë më tepër avancime/kualifikime/botime në revista të indeksuara për personelin akademik meritor (Standardi IV.5.kriteri 1.)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon se duhet të ketë më tepër trajnime për metodat e avancuara të mësimdhënies për personelin akademik.
2. GVJ rekomandon se në syllabuse të bëhet formatizimi i njëjtë si dhe të vendosen rezultatet e mësimdhënies, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti.





3. GVJ rekomandon që në të ardhmen Biblioteka e Fakultetit të Edukimit të pasurohet edhe më tepër me literature në disiplinën e edukimit fizik dhe sportive.
4. GVJ rekomandon të ketë mbështetje më të madhe financiare për veprimtari dhe aktivitete sportive në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtare.
5. GVJ rekomandon që dy paisjet laboratorike të përfituara nga projekti Tempus – Speed të vendosen në punë si një mundësi shumë e mirë për punime shkencore me eksperiment në laborator e jo thjesht të karakterit teorik.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Professional Master in "Physical Education and Sports Teacher with Minor Profile in Health Education" offered by the Institution of Higher Education University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.

Strengths and affirmations

1. The Faculty of Education, specifically the Department of Physical Education and Sports, through the academic staff, academic assistants and students, gives its contribution in the field of education and sports.
2. The Professional Master's study program in "Teacher in Physical Education and Sports with Minor Profile in Health Education" is of high quality. The program guarantees the preparation of students in accordance with the defined objectives.
3. The program is built in accordance with the vision, the mission of the institution, the needs of the market, the objectives of the reform of higher education in the country and the Bologna Process and has integrated the best contemporary foreign and domestic experience. The teaching plan, syllabuses, teaching and learning methods are according to the requirements of the academic standards.
4. The study program is implemented by full-time and part-time academic personnel who have degrees, titles and significant academic-scientific experience. This indicator guarantees a high quality of teaching.
5. The physical facilities, sports grounds and laboratories of the University of Elbasan, specifically of the Faculty of Education, are contemporary, reconstructed and suitable for the realization of its mission.
6. The university and the main unit have an institutionalized cooperation with counterpart institutions inside and outside the country. Through this cooperation, University of Elbasan successfully realizes the objectives for scientific research, exchange of experiences and guaranteed employment of graduates in this study program.





Weaknesses

1. The Faculty of Education has a not very rich Library, so it needs the purchase of new contemporary titles, but the library is equipped with computers for the online library (Standard IV.2).
2. There should be more advancements/qualifications/publications in indexed journals for meritorious academic personnel (Standard IV.5.criterion 1.)

Recommendation

1. External Evaluation Group recommends that there should be more training on advanced teaching methods for academic staff.
2. External Evaluation Group recommends that the same formatting be used in the syllabus as well as the teaching results, competencies and skills that the student acquires.
3. External Evaluation Group recommends that in the future the Library of the Faculty of Education be enriched even more with literature in the discipline of physical education and sports.
4. External Evaluation Group recommends to have greater financial support for sports activities at the national and international level.
5. External Evaluation Group recommends that the two laboratory equipment benefited from the Tempus - Speed project be put to work as a very good opportunity for scientific works with laboratory experiments and not just of a theoretical character.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | Nuk përbushen | Përbushen pjesërisht | Përbushen kryesisht | Përbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

